

MENAXHIMI I MENÇUR I PARAVE

Udhëzues për financa personale



Banka Popullore e
Republikës së Maqedonisë

Menaxhimi i mençur i parave

Udhëzues për financa personale



Banka Popullore e
Republikës së Maqedonisë

Botues:

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Bul. "Kuzman Josifovski – Pitu" nr. 1 1000 Shkup

Tel: (02) 3108 108;

Fax: (02) 3108 357

<http://www.nbrm.mk>;

Kryeredaktor:

Kristina Pavleska

Bordi Redaktues:

Aneta Krstevska, Violeta Stojanovska-Petreska, Ratka Celakovski, Ivana Boljat,
Darko Sozdov dhe Goran Lazarevski

Bashkëpunëtorë profesional të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë:

Bogoljub Jankoski, Natasha Andreeva, Igor Veliçkovski, Toni Mirçevski dhe
Anita Hegjkezi

Përshtatja e konceptit dhe përmbajtjes:

Kristina Pavleska dhe Olivera Panovska

Përkthim dhe përpunim i tekstit:

Arian Limani dhe Leudita Musa

Lektorim:

Leudita Musa dhe Liberta Domazet Sela

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë fitoi të drejtën ekskluzive nga Agjencia për Këshillim dhe Menaxhim me Kredi (AKMK) nga Malajzia të përkthejë, përshtatë në kontekst lokal, të përpunojë dhe printojë botimin "Menaxhimi i mençur i parave - Udhëzues për financat personale". Publikimin e përpunoi në bashkëpunim me institucionet e *Trupit Koordinues të Institucioneve Rregullatorë për Edukim Financiar në Maqedoni*: Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë, Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimeve, Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional dhe Komisioni për Letra me Vlerë të Republikës së Maqedonisë dhe Lidhja e Institucioneve Mikrofinanciare.



Koncepti, pozicionimi dhe litografia: Agjencia AKPK

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia: AKPK nuk ndërmerr asnjë përgjegjësi ose garanci për vërtetësinë dhe plotësinë e informacioneve në këtë libër.

Copyright: © 2018 Të gjitha të drejtat e botimit janë në pronësi të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë.

Ndalohet kopjimi dhe riprodhimi i këtij materiali.

Për përdorimin e të dhënave nga ky botim është e nevojshme të citoni burimin.


Informacionet në këtë libër janë të destinuara ekskluzivisht për qëllime edukative.

Botimi "Menaxhimi i mençur i parave - Udhëzues për financa personale", i shkruar në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, ka për qëllim të informojë popullatën se nevojitet menaxhim i mençur i mjeteve financiare për të arritur qëllimet e dëshiruara në jetë. Udhëzuesi është i destinuar për publikun e gjerë, duke afruar në mënyrë të thjeshtë konceptet themelore nga fusha e menaxhimit të financave personale deri tek gjeneratat më të reja dhe personat të cilët nuk kanë edukim ekonomik formal.

Gjegjësisht, udhëzuesi jep shpjegime për atë se si të menaxhohen paratë në mënyrë të mençur, si të përgatiten planet financiare dhe monitorohet zbatimi i tyre, si të jemi të kujdesshëm dhe të mos hyjmë në borxhe të tepërta financiare, përdorimin me kujdes të mjeteve të marra me kredi dhe kartë të kreditit dhe pagesën e detyrimeve në mënyrë të rregullt. Udhëzuesi shpjegon rolin e produkteve dhe shërbimeve bankare, institucioneve financiare, sigurimit dhe pensionimit. Udhëzuesi i numëron investimet financiare themelore, shpjegon depozitat bankare krahasuar me investimet në letra me vlerë, por nuk hy në detaje në aspektet të caktuara profesionale për atë se cili është portofoli optimal në rrethanat e dhëna, që do të ishte subjekt i përpunimit të literaturës profesionale së kësaj fushe.

Udhëzuesi përqendrohet edhe në marrjen e kontrollit mbi financat personale sot dhe në të ardhmen, sepse mënyra në të cilën përdoren paratë sot do të ketë ndikim mbi jetën në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, ky udhëzues porositi se duhet të jemi financiarisht të përgatitur të ballafaqohemi me situata dhe rrethana të paparashikuara gjatë jetës. Udhëzuesi është përshtatur me sistemin financiar të Republikës së Maqedonisë dhe nga afër e shpjegon rolin e institucioneve më të rëndësishme financiare.

Shkurtimisht, ky udhëzues synon të zhvillojë ndjenjën e menaxhimit të parave nga individët dhe amvisëritë në Republikën e Maqedonisë dhe rrjedhimisht të kontribuojë në ngritjen e nivelit të kulturës financiare të popullatës.



PËRMBAJTJA

Pjesa A Le të fillojmë

Pjesa 1	Pse kemi nevojë për planifikim financiar?	3
	Rreth planifikimit financiar	3
	Kuptimi i vlerës së parave	8
Pjesa 2	Fuqia e parave tuaja	15
	Vendosja e qëllimeve tuaja financiare	15
	Përmirësoni mirëqenien tuaj financiare	19
	Bazat e planifikimit të buxhetit	25
	Jetoni brenda mundësive tuaja	33
Pjesa 3	Produkte dhe shërbime financiare	37
	Produkte dhe shërbime bankare	37
	Bankingu përmes internetit dhe celularit	43

Pjesa B Realizimi i ëndrrave tuaja

Pjesa 4	Krijimi i pasurisë	51
	Shprehia e kursimit	51
	Rritja e pasurisë tuaj	53
	Llojet e investimeve	56
	Mashtrimet financiare	63
Pjesa 5	Sigurim për çdo situatë jetësore	67
	Pse kemi nevojë për sigurim?	67
	Produkte të sigurimit	68
	Informacione të dobishme rreth sigurimit	73

Pjesa C Menaxhimi i borxhit


Pjesa 6 Jeta me kredi	79
Paratë e huazuara - kredi dhe borxhe	79
Hua dhe kredi	79
Llojet e kredive	85
Kartelat kreditore, debitore dhe të tjera	91
Pagesat dhe mos përmbushja e detyrimeve	94

Pjesa Ç Qëllimet jetësore

Pjesa 7 Jetoni jetën tuaj	99
Karriera juaj	99
Blerja e veturës	104
Blerja e shtëpisë/banesës	106
Kur bëhet fjalë për zemrën	110
Kursimi për pension	113
 Pjesa 8 Dalja nga problemet financiare	 119
Vështirësitë financiare	119
Identifikoni sinjalet	122

Pjesa A

Le të fillojmë



Pjesa 1

Pse kemi nevojë për planifikim financiar?

Rreth planifikimit financiar

Çfarë bëni kur dëshironi të udhëtoni diku?

Sigurisht i parashtroni pyetjet në vijim:

- Cila është mënyra më e mirë të udhëtohet deri atje?
- Çka nëse bllokohet komunikacioni?
- A është më mirë të shkohet me veturë ose autobus?
- A duhet dikush të më dërgojë atje?



Vlerësoni opsionet të cilat i keni në dispozicion. Parashtroni pyetje rreth asaj se çka duhet të bëni dhe pastaj merrni vendim.

Përgjigjet e këtyre pyetjeve janë pjesë e procesit të planifikimit. Planifikimi mund të jetë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Njëjtë edhe me planifikimin financiar personal, vetëm se ai planifikohet për një periudhë më të gjatë kohore. Do të ishte ideale të planifikoni deri në vitet tuaja të pensionimit.

Planifikim financiar personal do të thotë të parashtroni pyetje për të tashmen dhe të ardhmen tuaj, për dëshirat dhe qëllimet tuaja. Duhet të mendoni rreth asaj që dëshironi të bëni në jetën tuaj, siç janë blerja e veturës ose shtëpisë, martesë, rritja e fëmijëve, arsimimi i tyre etj.



Për t'i realizuar dëshirat dhe qëllimet në jetë, duhet t'i planifikoni financat tuaja. Planifikimi financiar personal përfshin buxhetin tuaj (mjetet në dispozicion), kursimet dhe shpenzimet me kalimin e kohës.

Përparësitë e planifikimit financiar personal

Shumë njerëz mendojnë se planifikimi financiar është një proces kompleks dhe se i pengon ata të bëjnë gjëra që i kënaqin. Nëse vazhdimisht jetoni me një shumë të kufizuar të parave, sigurisht do duhet të sakrifikoni disa aktivitete. Paramendoni, nëse duhet të kurseni, mund të planifikoni paratë tuaja në mënyrë që të keni mjaftueshëm për të dalë me shokët tuaja dhe të kaloni mirë.

Nëse filloni me një shprehje të mirë për planifikim financiar, gjithmonë në të ardhmen do mund t'i lejoni vetes më shumë!

Me planin financiar, ju:

- Do të keni kontroll më të madh mbi financat tuaja dhe do të jeni në mundësi të shmangni shpenzimin e tepërt, borxhet dhe varësinë nga tjerët.
- Do të keni marrëdhënie më të mira me njerëzit përreth jush, familjen tuaj, miqtë dhe kolegët, sepse jeni të lumtur me jetën tuaj dhe nuk merrni borxh nga të tjerët.
- Nuk do të keni shqetësime financiare, sepse ju e keni planifikuar të ardhmen, i keni parashikuar shpenzimet dhe i keni realizuar qëllimet tuaja.
- Do të jeni më efikas në fitimin, përdorimin dhe ruajtjen e mjeteve tuaja financiare.



Me një plan të mirë financiar personal, planifikoni nevojat tuaja të ardhshme dhe mjetet të cilat i posedoni. Gjithashtu, do të jeni të qetë duke ditur se gjendja juaj financiare është nën kontroll.

Hapat e planifikimit financiar personal

Ekzistojnë 6 hapa në planifikimin financiar:

- 1 Vlerësimi i gjendjes aktuale financiare;
- 2 Vendosja e qëllimeve;
- 3 Përcaktimi i aktiviteteve që duhet të ndërmerren;
- 4 Përpunimi i planit financiar;
- 5 Zbatimi i planit dhe
- 6 Monitorim dhe rishikim i realizimit të planit.

Këto hapa do të shqyrtohen më hollësisht brenda këtij udhëzuesi.

Procesi i planifikimit financiar personal

Vlerësoni
gjendjen aktuale
financiare



Vendosni
qëllimet tuaja
financiare




Përcaktoni
alternativat të cilat do
të kënaqin qëllimet
financiare duke pasur
parasysh nevojat dhe dëshirat

- Bëni zgjedhje dhe zëvendësim
- Shtyni blerjet



Përcaktoni
aktivitetet të cilat
duhet të ndërmerrni

- Bëni plan për të ardhura dhe shpenzime
- Monitoroni prurjet dhe shpenzimet e parave, me dinamikë të caktuar kohore



Përgatitni planin
financiar dhe monitoroni
realizimin

- Përcaktoni produkte dhe shërbime të përshtatshme financiare
- Rritni pasurinë
- Mbroheni përmes sigurimit
- Administroni borxhet
- Planifikoni tatimet



Shqyrtoni dhe kohë
pas kohe rishikoni planin
financiar

- Duke pasur parasysh rrethana dhe situata të paplanifikuara në jetë



Vlerësoni si është gjendja e juaj financiare momentale

Qëllimet financiare në faza të ndryshme të jetës

Gjatë jetës tuaj, do të kaloni nëpër faza të ndryshme, që nga punësimi dhe ndërtimi i karrierës, martesës dhe rritjes së fëmijëve, deri në pensionim. Në faza të ndryshme të jetës, keni prioritete, përgjegjësi dhe qëllime financiare të ndryshme.

Në çdo fazë të jetës suaj krijohen mundësi dhe sfida të ndryshme për investim. Disiplina dhe këmbëngulja luajnë rol kyç në ruajtjen e gjendjes financiare. Vendosni nevojat dhe qëllimet tuaja në pajtim me ndryshimet në jetën tuaj, dhe me planifikimin e duhur financiar mundeni me sukses edhe t'i plotësoni ato.

Kur të jeni në të 20-tat, harxhoni para më ndryshe se kur jeni në të 50-tat. Për shembull, kur nuk jeni të martuar, sigurisht doni të keni mjaftueshëm para për të blerë një veturë ose të shkoni në pushime me shokët tuaj. Pasi të martoheni, ndoshta do të doni të blini shtëpi. Më vonë, kur të keni fëmijë, do të planifikoni për arsimimin e tyre dhe ndoshta do të kurseni për ditët e pensionit.



Në çdo rast, duhet patjetër t'i përshtatni prioritetet tuaja financiare për t'i kënaqur nevojat e llojllojshme në fazat e ndryshme të jetës tuaj. Prandaj, si do ti harxhoni parat tuaja varet nga qëllimet tuaja financiare. Në pjesët tjera të këtij libri, do të shqyrtojmë si mund t'i arrini qëllimet tuaja financiare. Megjithatë, vlen të theksohet se për t'i arritur qëllimet financiare, duhet të fitoni dhe kurseni para të mjaftueshme.

Kuptimi i vlerës së parave

Vlera e parave nga aspekti i kategorisë kohë

Paramendoni se ju ofrohet një shumë e caktuar parash dhe nga ju kërkohet të zgjidhni nëse i doni paratë tani ose pas një viti. Duke u bazuar në eksperiencën tuaj të deritanishme, është mirë të mendoni çka do të kishit mundur të blini me 1000 denarë në vitin 2005, dhe çka mund të blini tani? Pastaj vendosni nëse është më mirë t'i keni paratë tani ose më vonë.



Duhet të dini se paratë që do fitoni tani, vlejné më shumë se sa shuma e njëjtë e parave të fituara në të ardhmen. Ky është parim kyç i ekonomisë, i cili thotë se për paratë që i keni mund të përfitoni interes, prandaj edhe është më mirë që t'i pranoni ato sa më shpejt. Ky koncept e ilustron vlerën kohore të parave.

Le të shohim çka do të thotë ky koncept. Të themi se investoni para në librezën e kursimeve në bankë me normë vjetore të interesit prej 5%. Kështu, 1000 denarë sot do të vlejné 1.050 denarë për një vit (5% nga 1000 denarë = 50 denarë, ose $1000 \times 1,05 = 1.050$ denarë).

Në anën tjetër, 1000 denarë që do t'i fitonit pas një viti vlejné 952.38 denarë tani ($952,38$ denarë tani shumëzuar me 5% = 1.000 për një vit, ose $1.000 \div 1,05 = 952,38$). Kjo i paraqet humbjet të cilat dalin gjatë periudhës kur shuma nuk është në librezën e kursimit me normë vjetore të interesit prej 5%. Është shumë e thjeshtë!

Prej këtij shembulli mund të vërehet se paratë kanë vlerë kohore. Vlera momentale e parave është më e madhe nga vlera e shumës së njëjtë të parave në çfarëdo kohe në të ardhmen.

Fuqja e interesit

Paratë të cilat i kursejmë në bankë ose kursimore, do të na sjellin fitim (interes).

Sa e rëndësishme është të filloni të kurseni para tani, sesa ca kohë më vonë?

Shembull: Darkoja, Martini dhe Nikolla vazhdimisht investojnë një shumë të njëjtë parash, nga 3000 denarë në vit për 10 vite, me normë të njëjtë të interesit prej 5% në vit. Por, ata fillojnë të investojnë në moshë të ndryshme - Darkoja në moshën 18 vjeçare, Martini në moshën 28 vjeçare dhe Nikolla në moshën 38 vjeçare.

Në Nikolla 60 vjeçare kur të tre do të pensionohen, nëse i tërheqin paratë nga banka, Darkoja do të ketë më shumë para sesa Martini dhe Nikolla. Ai do të ketë 198.228 denarë, Martini do të ketë 121.695 denarë dhe Nikolla do të ketë 74.710 denarë, ashtu siç është paraqitur në tabelën më poshtë:

Moshë e kursimtarit në vite	Darkoja investon në moshë 18 vjeçare me 5% normë interesi		Martini investon në moshë 28 vjeçare me 5% normë interesi		Nikolla investon në moshë 38 vjeçare me 5% normë interesi	
	Investim në denarë	Investimi i rritur për normën e interesi në	Investim në denarë	Investimi i rritur për normën e interesi në	Investim në denarë	Investimi i rritur për normën e interesi në
18	3.000	3.150,00				
19	3.000	6.457,50				
20	3.000	9.930,38				
21	3.000	13.576,89				
22	3.000	17.405,74				
23	3.000	21.426,03				
24	3.000	25.647,33				
25	3.000	30.079,69				
26	3.000	34.733,68				
27	3.000	39.620,36				
28		41.601,38	3.000	3.150,00		
29		43.681,45	3.000	6.457,50		
30		45.865,52	3.000	9.930,38		
31		48.158,80	3.000	13.576,89		
32		50.566,74	3.000	17.405,74		

Vazhdon...

	Darkoja investon në moshë 18 vjeçare me 5% normë interesi		Martini investon në moshë 28 vjeçare me 5% normë interesi		Nikolla investon në moshë 38 vjeçare me 5% normë interesi	
	Investim në denarë	Investimi i rritur për normën e interesi në	Investim në denarë	Investimi i rritur për normën e interesi në	Investim në denarë	Investimi i rritur për normën e interesi në
33		53.095,07	3.000	21.426,03		
34		55.749,83	3.000	25.647,33		
35		58.537,32	3.000	30.079,69		
36		61.464,18	3.000	34.733,68		
37		64.537,39	3.000	39.620,36		
38		67.764,26		41.601,38	3.000	3.150,00
39		71.152,48		43.681,45	3.000	6.457,50
40		74.710,10		45.865,52	3.000	9.930,38
41		78.445,61		48.158,80	3.000	13.576,89
42		82.367,89		50.566,74	3.000	17.405,74
43		86.486,28		53.095,07	3.000	21.426,03
44		90.810,59		55.749,83	3.000	25.647,33
45		95.351,12		58.537,32	3.000	33.079,69
46		100.118,68		61.464,18	3.000	37.733,68
47		105.124,61		64.537,39	3.000	39.620,36
48		110.380,84		67.764,26		41.601,38
49		115.899,89		71.152,48		43.681,45
50		121.694,88		74.710,10		45.865,52
51		127.779,63		78.445,61		48.158,80
52		134.168,61		82.367,89		50.566,74
53		140.877,04		86.486,28		53.095,07
54		147.920,89		90.810,59		55.749,83
55		155.316,93		95.351,12		58.537,32
56		163.082,78		100.118,68		61.464,18
57		171.236,92		105.124,61		64.537,39
58		179.798,77		110.380,84		67.764,26
59		188.788,70		115.899,89		71.152,48
60		198.228,14		121.694,88		74.710,10
	Investimi total 30.000		Investimi total 30.000		Investimi total 30.000	

Edhe pse secili prej tyre ka investuar shumë të njëjtë, 30.000 denarë total, ne moshën 60 vjeçare Darkoja do të ketë më shumë para në krahasim me Martinin dhe Nikollën. Kjo ndodh kur kushtet ekonomike janë stabile gjatë tërë periudhës kohore të investimit.

Me rëndësi:

- Të ardhurat nga investimi mund të ndryshojnë gjatë viteve si pasojë e kushteve ekonomike dhe kushteve në tregun e kapitalit. Disa vite mund të jenë më të ulëta se 5% në vit, dhe disa vite më të larta se 5% në vit.
- Në shembullin e dhënë, investimi total të cilin Darkoja, Martini dhe Nikollën do e fitojnë në moshën 60 vjeçare do të jetë siç është paraqitur në tabelën më lart, nëse kthimi vjetor i investimit është vazhdimisht 5% në vit.

Rezultati në shembullin më lart është si pasojë e efektit të normës së interesit të përbërë. Ai paraqet interes shtesë të fituar në shumën e kursimit/investimit duke përfshirë interesin tashmë të fituar.

Fuqia e interesit të përbërë është se, sa më herët të filloni të kurseni, aq më i lartë do të jetë interesi i investimit tuaj fillestar. Kjo, thjeshtë, do të thotë sa më shumë para të leni anësh tani, aq më shpejt do të mund t'i plotësoni ëndrrat tuaja. Në pyetjen, kur është më mirë të filloni të kurseni, e dimë përgjigjen - TANI, kuptohet!

Si funksionon interesi i përbërë në bazë vjetore dhe mujore

Nëse futni 10.000 denarë në bankë me interes vjetor 5%, në fund të vitit do të keni 10.500 denarë. Nëse e leni shumën e tërë në bankë edhe për një vit tjetër, atëherë do të keni 11.025 denarë. Në vitin e dytë, jo vetëm që do të fitoni interes në investimin fillestar, gjithashtu do të fitoni interes mbi interesin të cilin e keni fituar në vitin paraprak. Kjo quhet interes i përbërë ose interesi i cili kalkullohet



mbi interesin (ose kapitalizimi i interesit).

Interesi i përbërë është i rëndësishëm për investorët të cilët mund t'i lejnë investimet e tyre të rriten për një periudhë më të gjatë kohore. Investimi prej 10.000 denarësh i përmendur më lart, kur do investohet për 10 vjet me 5% interes, do të arrijë shumën 16.289 denarë!

Nëse interesi llogaritet në bazë mujore, norma mujore e interesit është 0.42% (5% në vit e ndarë për 12 muaj). Nëse shuma e njëjtë prej 10.000 denarësh investohet në bazë të 0.42% në muaj dhe investohet për 10 vite, do të vlejë 16.401 denarë, që është për 112 denarë më shumë se sa të investohet me normë vjetore prej 5%. Kështu që, do të fitoni më shumë nëse interesi i investimit llogaritet në bazë mujore në vend të asaj vjetore.

Megjithatë, interesi i përbërë mund të jetë "thikë me dy presa". Mund të jetë i dobishëm për ju, por edhe të mos ju shkojë në favor, varësisht nga ajo nëse kurseni ose keni borxhe. Nëse kurseni, mund të fitoni kthim më të madh të investimit tuaj si rezultat i rritjes së shumës së interesit, respektivisht do të fitoni të ardhura më të mëdha nga interesi nëse parat tuaja investohen për një periudhë më të gjatë kohore.

Në të kundërtën, nëse keni borxh kredie ose kartë të kreditit, do të paguani interes më të lartë sepse borxhet janë të llogaritur në bazë të zmadhuar si pasojë e shtimit të interesit. Kjo ndodh nëse vononi pagesën e kreditit ose kartelës kreditore për një kohë më të gjatë, do ju llogaritet interes më i lartë dhe me kalimin e kohës do jetë më vështirë të shlyeni borxhin për kredinë ose kartën e kreditit.



Mbani mend

- Planifikimi financiar personal është i rëndësishëm për t'ju siguruar qetësi, siguri për të ardhmen tuaj dhe cilësi më të mirë të jetës.
- Planifikimi financiar personal është i rëndësishëm për realizimin e ëndrrave dhe qëllimeve në jetë.
- Nëse me paratë që posedoni mund të fitoni interes, shuma e njëjtë e parave vlen më shumë aktualisht, se sa të fitoni atë në të ardhmen.
- Është e rëndësishme që të filloni të kurseni paratë tuaja TANI. Sa më shpejt të filloni të kurseni dhe sa më gjatë, aq më i madh do të jetë përfitimi nga interesi i përbërë.
- Do të fitoni interes më të madh nëse për investimin tuaj pranoni interes në bazë mujore në vend të asaj vjetore.
- Interesi i përbërë është "thikë me dy presa", në varësi nga ajo a kurseni apo keni borxh. Nëse kurseni dhe paratë tuaja janë të investuara për një periudhë më të gjatë kohore, do të fitoni kthim më të madh nga interesi. Nëse e vononi pagesën e kredisë ose borxhit të kartelës kreditore, në fund do të paguani interes më të lartë.



Vendosja e qëllimeve tuaja financiare**Pse është e rëndësishme?**

Në futboll, qëllimi i rrjetën është të fusin topin në rrjetën e ekipit kundërshtar.

Lëvizin hap pas hapi, adoptojnë strategji pastaj një tjetër, me qëllim që të çojnë topin përpara dhe në gol.



A mund të paramendoni të luani futboll pa asnjë qëllim? Të gjithë lojtarët tuaj të preferuar thjeshtë do të vrapojnë nëpër fushën e madhe dhe të gjelbër duke mos shkuar askund, duke mos arritur asgjë edhe më e keqja - duke mos arritur asnjë QËLLIM - duke mos shënuar gol! Nuk ekziston lojë futbollit pa qëllim.

Njëjtë si futbollistët, edhe ju duhet të keni qëllime. Qëllimet ju japin drejtim, sepse ata j'u çojnë drejt realizimit të asaj që ju e dëshironi. Pa qëllime, do të zgjoheni një ditë dhe do të kuptoni se vitet kanë kaluar, dhe ju akoma nuk keni arritur asgjë të rëndësishme!

Vlen të theksojmë se paratë janë mjet i rëndësishëm për realizimin e qëllimeve në jetë. Siç folëm në pjesën e parë, paratë tuaja duhet t'i menaxhoni përmes planifikimit financiar. Një prej hapave të planifikimit financiar është vendosja e qëllimeve financiare.

Si t'i vendosni qëllimet tuaja financiare?

Qëllimet financiare do ju ndihmojnë të përcaktoni prej ku dhe në bazë të cilës do të realizoni të ardhura parash dhe për çfarë qëllimesh do t'i harxhoni.

Gjatë vendosjes së qëllimeve, kushtoni vëmendje asaj që është e rëndësishme në jetën tuaj. Pa e ditur çka është e rëndësishme për ju dhe më të afërmit tuaj, do të jetë vështirë të vendosni qëllimet financiare. Kur të përcaktoni prioritetet tuaja, do të jetë më lehtë të vendosni dhe të realizoni qëllimet financiare.

Shënoni qëllimet tuaja financiare! Nuk është e mjaftueshme vetëm t'i mendoni ato. Me shënimin e tyre do të rriten shanset për realizimin e qëllimeve financiare.

Bëhuni sa më të saktë që është e mundur! Cila është domethënia e shënimit: "Qëllimi im është të kem shumë para në bankë" Çka paraqet për ju "shumë në para"? A është ajo 500 denarë, 5.000 denarë ose 50.000 denarë? Bëhuni të saktë dhe shënoni qëllimet tuaja në kuptim që ata të jenë të matshme. Ndani ato në qëllime në afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.



Qëllimet e mia:

Hapi 1

Përcaktoni dhe shënoni qëllimet tuaja, për shembull:

- Blerja e veturës së re;
- Kursim për regjistrim në fakultet;
- Shkuarja në pushim vjetor;
- Pagesa e borxhit të kartës së kreditit;
- Kursime për ditët e pensionit.



Shembuj:

Qëllim afatshkurtër (më pak se 1 vit):

- Kurseni 15.000 denarë brenda nëntë muajve për pushim vjetor;
- Kurseni 20.000 denarë brenda një viti për pagesë të borxhit të kartës së kreditit.

Qëllime afatmesme (prej 1 deri 3 vite):

- Kurseni 120.000 denarë brenda një viti për arsim të lartë dhe

Qëllime afatgjata (më shumë se 3 vite):

- Kurseni 300.000 denarë brenda pesë viteve në llogarinë pensionale në fondin pensional vullnetarë; dhe
- Kurseni mjaftueshëm para për pjesëmarrje gjatë blerjes së veturës së re me kredi.

Hapa të thjeshta në vendosjen e qëllimeve tuaja financiare

Hapi 2

Ndani qëllimet në:

- Afatshkurtra (më pak se 1 vit);
- Afatmesme (prej 1 deri 3 vite) dhe
- Afatgjata (më shumë se 3 vite).

që t'i monitoroni dhe realizoni më lehtë.



Përdorni tabelën më poshtë për të shkruar qëllimet tuaja financiare:

Qëllimet e mia financiare		
Afatshkurtra	Afatmesme	Afatgjata

Qëllim i rëndësishëm - kursim për situata të jashtëzakonshme

Çfarë do të ndodh nëse si pasojë e rrethanave të paparashikuara nuk do mundeni të paguani arsimimin tuaj? A do të sakrifikoni një diplomë nga institucioni i arsimit të lartë? A keni menduar për një fond rezervë për situata të jashtëzakonshme?

Ka shumë pasiguri që mund të hasen në jetë. Ngjarje të papritura të natyrave të ndryshme, nga defekti më i vogël i veturës deri në fatkeqësitë natyrore katastrofale që mund t'i ndodhin çdokujt.

Në shumicën e situatave nevojiten para. Është jashtëzakonisht e rëndësishme të jeni të përgatitur me aftësi dhe njohuri të duhura dhe të reagoni me vendosmëri dhe me efikasitet për t'u ballafaquar me problemet të cilat nuk ju kanë ndodhur më parë në jetë. Fondi juaj rezervë për raste emergjente është një vegël që mund ta përdorni për t'i përmirësuar aftësitë dhe njohuritë tuaja.

Domethënë, kur t'i shënoni qëllimet tuaja financiare, përfshini edhe kursimin shtesë për raste emergjente. Preferohet që në fondin tuaj për raste emergjente të mbani shumë me vlerë të shpenzimeve themelore për jetë për më së paku gjashtë muaj.

Shembull:

Nëse ju nevojiten 10.500 denarë në muaj për të paguar shpenzimet për jetë, përfshirë edhe pagesat fikse siç janë kredia ose qiraja dhe primi për sigurim, si dhe fatura për rrymë elektrike dhe ujë, duhet të keni më së paku 63.000 denarë në fondin tuaj për raste emergjente (respektivisht 10.500 denarë x 6 muaj). Dhe nëse është e mundur, në fond kurseni dyfish më shumë, respektivisht kurseni shumën e njëjtë për një kohë më të gjatë (10.500 denarë x 12 muaj = 126.000 denarë).

Në fillim kur do të punësoheni, mund të jetë vështirë të leni anash aq para, por përpiquni të punoni në atë drejtim me kalimin e kohës. Çdo shumë e vogël do të ndihmojë të ndërtoni fondin tuaj për raste emergjente. Mos harroni se duhet të bëni përpjekje të vetëdijshme për kursim dhe të ruani mjetet e ndara vetëm për raste emergjente.



Përmirësoni mirëqenien tuaj financiare

Mjete dhe detyrime: çka posedoni dhe çka keni borxh

Në planifikimin financiar, duhet të vlerësoni ku gjendeni tani për nga aspekti financiar, çka posedoni dhe çka keni borxh, sa para keni dhe sa para do ju mbesin pas kryerjes së pagesave të ndryshme.

Kur e bëni këtë, mund t'ju ndihmojnë dy lloje të raporteve financiare:

- Bilanci personal;
- Pasqyrë personale e rrjedhës së parasë.

Këto raporte do ju ndihmojnë:

- Të siguronit të dhëna për gjendjen financiare aktuale dhe për totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Të monitoroni realizimin e qëllimeve tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata;
- Të mbani evidencë për aktivitetet e juaja financiare, siç janë investimet dhe shpenzimet tjera; dhe
- Të ruani të dhëna të cilat mund t'i përdorni gjatë përgatitjes së formularëve tatimor ose aplikimit për hua bankare ose hua nga institucioni jo-bankë (p.sh kursimore).

Bilanci personal paraqet çka posedoni dhe çka keni borxh:

- Posedoni (mjete) - para, kursime, pasuri të patundshme, fonde investuese, aksione në kompani etj; dhe
- Keni borxh (detyrime) - borxhe në banka, kursimore, familjes ose shokëve, borxh të kartave të pagesave, qira për banesë, shtëpi, fatura për shpenzime të përgjithshme (rrymë elektrike, ujë, telefon, nxemje, strehim) etj.

Bilanci personal është si kartë financiare përmes së cilës rregullisht mund të monitoroni gjendjen tuaj financiare, që mund të jetë bazë gjatë marrjes së vendimeve lidhur me paratë.



Bilanci personal

Më poshtë është paraqitur një bilanc personal, që mund ta përdorni si shembull. Ky bilanc personal ka vlerë pozitive neto, sepse vlera e totalit të mjeteve është më e madhe nga vlera e totalit të detyrimeve.

	Artikulli	Mjete	Detyrime
Llogari bankare	Llogaria për kursime	10.000	
	Llogari rrjedhëse	13.000	
	Llogari devizore	20.000	
	Para të gatshme	1.000	
Pasuri e patundshme	Banesë	1.250.000	500.000
	Shtëpi		
	Tokë		
	Stoli	60.000	
	Veturë	300.000	200.000
Investimet	Fondi pensional	150.000	
	Fond investues	15.000	
	Aksione		
Hua bankare	Karta të kreditit		100.000
	Kredi për studentë		
	Huamarrje nga shokët dhe familja		
	Total	(A) 1.819.000	(B) 800.000
	Neto (A) - (B)	1.019.000	

Bilanci neto

Bilanci i juaj neto paraqet dallimin midis totalit të mjeteve dhe detyrimeve. Neto bilanci pozitiv është kur posedoni më shumë pasuri se sa keni borxh. Është mirë bilanci i juaj neto të jetë pozitiv.

Nëse aktualisht keni neto bilanc pozitiv, nuk do të thotë se asnjëherë nuk do të ballafaqoheni me vështirësi financiare. Kur mjetet nuk janë likuide (nuk mund lehtë t'i ktheni në para të gatshme), mund të paraqiten probleme. Le të shohim përmes një shembulli... Si është e mundur që me neto bilanc pozitiv të hyni në probleme financiare?

Të themi se posedoni një shtëpi si pasuri (ku jetoni) dhe nuk keni para të gatshme në kuletën tuaj ose mjete në llogari dhe tanimë jeni vonë me pagesën e borxheve (kredive, llogarive etj). Nëse jeni të papunësuar dhe nuk keni mundësi të fitoni para në ndonjë mënyrë tjetër, në një situatë pa rrugëdalje, do të vendosni të shitni shtëpinë tuaj që të mbuloni borxhet. Këtu paraqiten probleme shtesë. Nuk mundeni menjëherë të shitni shtëpinë tuaj për të fituar para, sepse shtëpia, si një mjet jo-likuid, nuk shitet lehtë dhe gjetja e një blerësi mund të zgjasë disa muaj. Shtëpia është gjithashtu vendi ku ju dhe familja juaj jetoni dhe nuk mund të shpërnguleni aq thjeshtë.

Të jesh financiarisht i shëndoshë do të thotë të kesh një portofol të balancuar të mjeteve, kështu që do të keni para në çdo kohë për nevoja të ndryshme.

Kur keni më shumë borxhe se sa pasuri, keni neto bilanc negativ. Në këtë rast, nuk jeni në gjendje t'i paguani borxhet tuaja kur ata maturojnë, sepse nuk keni para ose mjete likuide të mjaftueshme. Ju në të vërtetë keni probleme të mëdha financiare (shih pjesën 8).

Neto bilanci i juaj jep pasqyrë për pozitën tuaj financiare në datë të caktuar. Mos i llogaritni mjetet tuaja jo-likuide si mjete për pagesë sepse ata nuk mund lehtë dhe shpejt të kthehen në para të gatshme.




Llogaritni neto bilancin tuaj

Hapi 1 - Shënoni sendet me vlerë që i posedoni



Para të gatshme, llogari transaksionesh dhe depozita pa afat



Investime siç janë aksione, obligacione dhe fonde investuese



Fonde pensioneale



Pasuri të patundshme siç janë shtëpitë, banesat edhe toka



Sendet personale të cilat mund të shiten për para, siç janë stolitë, ari, vepra artistike dhe antike



Hapi 2 - Llogaritni shumën totale të mjeteve tuaja



Hapi 3 - Shënoni sendet të cilat i keni borxh



Kredi, siç janë, kredi bankare dhe të tjera



Bilance negative të kartave të kreditit



Tatime, si tatimet për pasuri të patundshme, tatim i fitimit



Borxh ndaj familjes, miqve dhe personave të tjerë



Pagesa në këste për mallra për konsumim të gjerë, siç janë mobiliet dhe teknologjia



Hapi 4 - Llogaritni shumën totale të detyrimeve tuaja



Hapi 5 - Bëni llogaritjen përfundimtare duke hequr shumën totale të detyrimeve nga shumën totale të mjeteve (mjete minus detyrime)

Nëse bilanci është pozitiv, ajo është një shenjë e mirë, por duhet të planifikoni të rritni neto bilancin tuaj në të ardhmen. Nëse është negativ, mos dëshpëroheni dhe ndërmerrni masa për të përmirësuar situatën financiare.

Ekzistojnë disa mënyra për të rritur neto bilancin tuaj, si për shembull:

- Rritja e kursimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve;
- Zvogëlimi i borxheve;
- Shitja e mjeteve të cilat nuk sjellin kthim.

Bazat për planifikimin e buxhetit

Buxhet i të ardhurave dhe shpenzimeve

Gjatë planifikimit financiar, është e rëndësishme të përgatitet një buxhet. Vërtetë, të jetosh sipas një buxheti të planifikuar kërkon shumë disiplinë, por ju ndihmon:

- Të jetoni në korniza të të ardhurave tuaja mujore;
- Të kurseni para;
- Të arrini qëllimet tuaja financiare;
- Të përgatiteni për situata të paparashikueshme;
- Të fitoni shprehi për menaxhimin e financave tuaja përmes kontrolleve të rregullta të neto bilancit tuaj.



Është mirë të përgatitni buxhetin tuaj në fillim të muajit ose ditës kur pranoni pagën tuaj mujore.

Kur të përgatitni buxhetin tuaj personal:

- Llogaritni të ardhurat tuaja për periudhën buxhetore. Kjo përfshin: pagën tuaj, tarifatat edhe burime tjera të të ardhurave shtesë.
- Kurseni së paku 10% të të ardhurave tuaja.
- Leni një shumë të caktuar parash në fondin tuaj për raste emergjente.
- Llogaritni shpenzimet fikse për periudhën buxhetore që zakonisht duhet të paguhet ose harxhohen në bazë mujore. Kjo përfshin: qira për shtëpi ose banesë, pagesa e kësteve të kredive, prurje sigurimesh dhe të tjera;
- Llogaritni shpenzimet e ndryshueshme për periudhën buxhetore. Kjo përfshin: lëndë djegëse, produkte ushqimore, fatura për shpenzime të përgjithshme (fatura për rrymë elektrike, ujë, telefon, nxehje, strehim);
- Vlerësoni shpenzimet tjera të cilat mund të vendosni nëse do i bëni ose jo. Ato përfshijnë: dhurata, hobi, argëtim dhe pushim vjetor; dhe
- Keni parasysh qëllimet tuaja financiare. Krahasoni buxhetin tuaj me qëllimet tuaja financiare të shihni nëse i realizoni ato ose jo. Për shembull, nëse keni vendosur të paguani pjesëmarrjen për të blerë automobil të ri me anë të kredisë, kontrolloni çdo muaj që të siguroheni se ruani një shumë të mjaftueshme parash për të realizuar këtë qëllim financiar.




Për të përgatitur një buxhet të suksesshëm, nevojitet:

- Të jeni të disiplinuar dhe sistematik. Për të përgatitur një buxhet të mirë, nevojitet kohë dhe përpjekje. Mos dorëzoheni edhe pse ka shumë për t'u bërë!
- Të jeni real gjatë llogaritjeve. Nëse keni të ardhura modeste, mos mendoni se do të kurseni shumë para për një afat të shkurtër;
- Të jeni të përgatitur. Mund të paraqiten shpenzime të papritura shtesë dhe mund të ketë edhe ndryshime në çmimet e tregut; dhe
- Të jeni fleksibil. Kurseni para për argëtim. Ndoshta dëshironi të dilni në mbrëmje me miqtë tuaj, të shkoni në palestër, kinema, teatër, koncert etj.
- Të rishikoni buxhetin tuaj kur është e nevojshme

Mbani mend: buxheti do të jetë i suksesshëm vetëm nëse rregullisht monitoroni realizimin e tij!

Monitorimi i parave të gatshme

Përgatitja e buxhetit tuaj personal nuk është fundi i procesit. Duhet të monitoroni hyrjet dhe daljet e parave të gatshme gjatë një periudhe të caktuar.



*Suficit = teprica

*Deficit = mangësi

Të ardhurat tuaja më të rëndësishme janë të ardhurat nga puna. Megjithatë, mund të keni burime tjera të ardhurash, siç janë interesi i kursimit, fitimi në tjera baza, investime, qira etj. Ndërsa dalje janë shpenzimet për jetë, pagesa e kredive dhe detyrime tjera financiare.

Nëse keni tepriçë të parave të gatshme, kjo është fantastike! Mund t'i vendosni paratë në librezën tuaj të kursimeve. Megjithatë, nëse keni deficit të parave të gatshme, kontrolloni shpenzimet edhe një herë! Tani për tani, përpiqeni të shtyni blerjet ose pagesat e caktuara. Përpiqeni të mos e përdorni fondin tuaj për raste emergjente, vetëm në raste kur ajo është e pashmangshme! Përdorni kartën tuaj të kreditit si mjeti i fundit, sepse nëse e përdorni për mbulimin e borxheve ajo vetëm do i rrisë shpenzimet tuaja për muajt e ardhshëm.

Gjatë përgatitjes së buxhetit për muajin e ardhshëm, merrni parasysh gjendjen e muajit paraprak.



Siç edhe rregullisht e kontrolloni dhe rishikoni buxhetin tuaj, ashtu rishikoni edhe planin për shpenzim. Nëse duhet të zvogëloni shpenzimet, fillimisht shihni ato pa të cilat mund të funksiononi. Ndoshta duhet të rishikoni edhe qëllimet tuaja financiare, nëse disa prej tyre janë joreale në raport me të ardhurat tuaja mujore.

- Saldoja e bilancit tuaj paraqet gjendjen tuaj neto.
- Buxheti i juaj tregon sa janë të ardhurat, kursimet dhe shpenzimet tuaja të planifikuara me qëllim realizimin e qëllimeve tuaja financiare.
- Raporti i juaj për para të gatshme i paraqet hyrjet dhe daljet e parave të gatshme gjatë periudhës së caktuar.

Më poshtë është dhënë një shembull i një raporti në të cilin kombinohet buxheti i planifikuar personal dhe raporti për para të gatshme sipas hyrjeve dhe daljeve të realizuara. Në shembull, daljet e parave të gatshme neto janë më të ulëta se plani, që tregon shpenzime më të ulëta dhe kursim ose tepricë në financat personale.

Buxheti personal mujor dhe Raporti për para të gatshme

Artikulli	Buxheti personal (plan)	Hyrje dhe dalje e parave të gatshme (të realizuara)
Paga (neto)	33.000	33.000
Burime tjera	—	—
Totali i të ardhurave mujore	33.000	33.000
Zvogëlim për:		
Kursim (10% i të ardhurave mujore)	3000	3000
Fond për raste emergjente	1000	1000
Të ardhura (kursimi neto)	29.000	29.000
Zvogëlim për: Shpenzime fikse		
Qira	3790	3790
Kësti i kredisë për banim	—	—
Kësti i kredisë për veturë	7200	7200
Sigurimi i veturës (auto-përgjegjësi)	4500	4500
Totali i shpenzimeve fikse	15.490	15.490

*Vazhdon në faqen tjetër

Buxheti personal mujor dhe Raporti për para të gatshme

Artikulli	Buxheti personal (plan)	Hyrje dhe dalje e parave të gatshme (të realizuara)
Zvogëlim për: Shpenzime të ndryshueshme		
Ushqim	3000	3500
Shërbime komunale për shtëpinë	350	355
Fatura për telefonin celular	500	600
Lëndë djegëse	1000	800
Shërbime dhe mirëmbajtje	100	150
Parkim/Taksë e rrugës	100	120
Riparimi i veturës	5000	—
Totali i shpenzimeve të ndryshueshme	10.050	5.525
Zvogëlim për: Shpenzime të tjera		
Shpenzime shëndetësore	60	—
Veshmbathje	1000	350
Argëtim	500	700
Pajisjet shtëpiake	900	500
Sende personale	100	150
Dhurata	800	—
Shpenzime tjera	100	50
Totali i shpenzimeve tjera	3460	1750
Totali i shpenzimeve	29.000	22.765
Dallimi mes kursimit neto dhe totalit të shpenzimeve	0	+ 6.235
Suficit (+) / Deficit (-)		

Ndoshta do të dëshironit të përgatitni buxhetin tuaj personal në bazë të shembullit paraparak në tabelën më poshtë:

Artikulli	Buxheti personal (plan)	Hyrje dhe dalje e parave të gatshme (të realizuara)
Paga (neto)		
Burime tjera		
Totali i të ardhurave mujore		
Zvogëlim për:		
Kursim (10% i të ardhurave mujore)		
Fond për raste emergjente		
Të ardhura (kursimi neto)		
Zvogëlim për: Shpenzime fikse		
Qira		
Kësti i kredisë për banim		
Kësti i kredisë për veturë		
Sigurimi i veturës (auto-përgjegjësi)		
Totali i shpenzimeve fikse		

Artikulli	Buxheti personal (plan)	Hyrje dhe dalje e parave të gatshme (të realizuara)
Zvogëlim për: Shpenzime të ndryshueshme		
Ushqim		
Shërbime komunale për shtëpinë		
Fatura për telefonin celular		
Lëndë djegëse		
Shërbime dhe mirëmbajtje		
Parking/Taksë e rrugës		
Riparimi i veturës		
Totali i shpenzimeve të ndryshueshme		
Zvogëlim për: Shpenzime tjera		
Shpenzime shëndetësore		
Veshmbathje		
Argëtim		
Pajisjet shtëpiake		
Sende personale		
Dhurata		
Shpenzime tjera		
Totali i shpenzimeve tjera		
Totali i shpenzimeve		
Dallimi mes kursimit neto dhe totalit të shpenzimeve		
Suficit (+) / Deficit (-)		

Jetoni brenda mundësive tuaja

Nevoja dhe dëshira

Kur jetoni brenda mundësive tuaja, shpenzoni aq para sa keni. Njëkohësisht, kurseni për t'i përmbushur qëllimet tuaja financiare.

Është lehtë të shpenzohet më shumë. Produktet reklamuese vazhdimisht i shohim në televizion, borde reklamash, revista, gazeta, media shoqërore etj. Vetëm nga vullneti juaj varet nëse do të jeni në gjendje të rezistoni të gjithë joshjet. Kjo arrihet vetëm nëse e dini çka ndikon mbi shpenzimet tuaja dhe cilat janë nevojat dhe dëshirat tuaja.

Çfarë është "nevoja"?

Nevojë është diçka që patjetër duhet ta keni, pa të cilën nuk mund të jetoni. Shembull për nevojën është ushqimi. Duhet të hani që të jetoni.

Çfarë është "dëshira"?

Dëshira është diçka që dëshironi të keni, por jo absolutisht e nevojshme. Shembull për dëshirën është stolia. Mund të blini stoli, por edhe nuk është e nevojshme.

Megjithatë, nevojat ndryshojnë me kalimin e kohës. Në botën e sotme, telefoni celularë është nevojë për komunikim me njerëz tjerë. Megjithatë, telefoni celularë i cili ka procesor të avancuar ose rezolucion të mirë të kamerës është diçka që "është mirë ta kesh".



Njohja e dallimit mes nevojave dhe dëshirave ndikon mbi vendimet tuaja për shpenzim. Vendimet të cilat i sillni në raport me atë që ju nevojitet ose atë që dëshironi, do të ndikojnë në buxhetin tuaj dhe shpenzimet mujore.

Shpenzoni me mençuri

Kur dëshironi të blini diçka, pyetni veten - A është diçka që më nevojitet? A mund t'ia lejoj vetes ta blejë?

Buxheti juaj personal dhe paratë e gatshme do ju ndihmojnë t'u përgjigjeni këtyre pyetjeve. Kontrolloni nëse keni mjete të mjaftueshme ose tanimë keni shpenzuar më shumë se sa keni planifikuar për atë muaj.

Nëse bëhet fjalë për dëshirë, mendohuni a të blini diçka, ose të shpenzoni për ndonjë produkt të ngjashëm me një shumë më të vogël dhe do të mund të kurseni më shumë para. Në këtë mënyrë, shpenzoni me mençuri dhe jetoni brenda mjeteve që posedoni.

Blerja e arsyeshme dhe shpenzimi i mençur do ju parandalojnë të krijoni vështirësi financiare për veten dhe të afërmit tuaj. Menaxhoni financat tuaja personale në mënyrë të ndërgjegjshme - është e lehtë - vetëm thuani "jo" për blerjet të cilat nuk mund t'i lejoni.



Shtyni blerjet

A ju kujtohen ditët tuaja të fëmijërisë kur donit akullore dhe nëna e juaj ju thoshte se mund të blini më vonë, pasi ti kryeni detyrat e shtëpisë? Ju kujtohet se si e pyesnit babin tuaj nëse mund t'ju blejë një biçikletë të re dhe ai ju thoshte se mund ta fitoni atë, nëse merrni nota të mira në shkollë? Në të dy situatat, prindërit tuaj ju mësonin t'i shtyni blerjet.

Gjatë jetës tuaj, gjithmonë do të ketë ndonjë person i cili do të mundohet të ketë ndikim mbi shpenzimin e parave tuaja. Qoftë shoku i juaj i cili kërkon të dilni në mbrëmje, qoftë agjenti i marketingut, i cili kërkon nga ju të blini produktin e ri.



Në situatën e caktuar mendoni nëse është e nevojshme të shpenzohen para dhe nëse ai shpenzim është brenda buxhetit tuaj? Kur do t'i thoni "jo" shpenzimit të parave (shtyni blerjen), ju jeni një hap më afër realizimit të ëndrrave tuaja financiare.

Në jetë, gjithmonë ekzistojnë zgjedhje alternative. Konsideroni alternativa të ndryshme për nevojat dhe dëshirat tuaja. Nëse është e nevojshme, ndryshoni perceptimet tuaja. Në vend që të blini veturë, përdorimi i transportit publik mund të jetë një zgjidhje e mirë për lëvizje nëpër qytet. Do të kurseni para dhe do të kontribuoni për një mjedis më të pastër jetësor. Ose në vend që të shkoni në pushime në një vend të largët ekzotik, shkoni në ndonjë vend më afër, ku gjithashtu ka natyrë të bukur dhe mund të pushoni mirë.

Mbani mend:

- Vendosja e qëllimeve financiare është e rëndësishme për tu arritur siguria dhe liria financiare;
- Qëllimet e juaja financiare duhet t'i pasqyrojnë vlerat dhe besimet tuaja;
- Shënoni qëllimet tuaja financiare, pastaj kategorizoni ato në afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata;
- Kurseni për një fond për raste emergjente;
- Bilanci i juaj personal i tregon mjetet tuaja, detyrimet dhe neto bilancin në momentin e dhënë;
- Përgatitja e buxhetit dhe monitorimi i flukseve të parave tuaja të gatshme është një proces i cili kërkon durim, disiplinë dhe fleksibilitet; dhe
- Është shumë e rëndësishme të jetoni brenda mundësive tuaja financiare.



Produkte dhe shërbime bankare

Bankat janë institucionet më të vjetra financiare. Ato janë institucionet kryesore financiare ku ruhet një pjesë e konsiderueshme e kursimeve të popullatës. Kjo është veçanërisht karakteristike për vendet me sistem më pak të zhvilluar financiar. Bankat bashkëkohore paraqesin institucione universale, me më shumë shërbime, sepse aktivitetet e tyre nuk janë të kufizuara vetëm në veprimtari tradicionale bankare (mbledhja e depozitave dhe miratimi i kredive), por ata ofrojnë edhe një sërë shërbimesh jo-bankare. Roli kryesor i sistemit bankar është t'ju mundësohet subjekteve me mjete të tepërta financiare t'i investojnë dhe t'i transferojnë mjetet deri tek subjektet të cilat kanë mungesë të mjeteve financiare, me qëllim përfundimtar - fitimin.

Puna e bankave, duke filluar nga marrja e lejes për punë, është objekt monitorimi nga një autoritet rregullator, shpesh nga banka qendrore e shtetit, që në vendin tonë është Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (BPRM)

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë është një prej institucioneve më të rëndësishme në Republikën e Maqedonisë. Ajo ka funksione të veçanta, të cilat janë të qenësishme vetëm për të dhe për asnjë institucione tjetër në vend.

Edhe pse emri përmban termin "bankë", BPRM dallon nga bankat tjera në Republikën e Maqedonisë. Kjo do të thotë se qytetarët ose korporatat nuk mund të kenë llogari në BPRM. Në BPRM nuk mund të kursehet, as të merret kredi.

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë është bankë qendrore e Republikës së Maqedonisë. Ajo është institucioni më i

lartë bankar në vendin tonë i cili emeton dhe kontrollon paratë në ekonomi. Me emetimin e parave kryen emetimin e valutës kombëtare, denarit, i cili është mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë dhe prandaj ajo quhet edhe bankë emetuese.

Puna e BPRM-së është e rregulluar me ligj të veçantë - Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë. BPRM menaxhohet nga Këshilli i BPRM-së, ndërsa guvernatori ka funksionin kryesor ekzekutiv dhe menaxhon punën e përditshme.

Qëllimi kryesor i BPRM-së është të ruaj çmime stabile, gjegjësisht të mbajë stabilitetin e çmimeve në ekonomi. Qëllimi i dytë është të kontribuojë në ruajtjen e një sistemi financiar stabil, konkurrues dhe të orientuar kah tregu, gjegjësisht kujdeset për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Atë e bën përmes funksionit të saj rregullatorë dhe mbikëqyrës mbi bankat. Qëllimi i tretë është të përkrah politikën e përgjithshme ekonomike pa e cenuar qëllimin e parë. Qëllimi i dytë dhe i tretë janë të nënrenditura pas qëllimit kryesor.

BPRM-ja krijon dhe zbaton politikën monetare përmes një sërë instrumentesh dhe veprimesh me anë të së cilave e rregullon ofertën e parave në ekonomi dhe çmimin e tyre. BPRM-ja e përcakton dhe e zbaton politikën e kursit të këmbimit; BPRM-ja mbikëqyr bankat. BPRM-ja ruan dhe menaxhon rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë; BPRM-ja kujdeset që paratë vazhdimisht të qarkullojnë nëpër ekonomi, rregullon qarkullimin pagesor në vend dhe mbikëqyr sistemet e pagesave të vendit përmes të cilave kryhen pagesat. BPRM-ja kryen rolin e agjentit të shtetit dhe veprime tjera lidhur me kryerjen e detyrave të saj.

Për më shumë informacione vizitoni internet faqen e Bankës Popullore në adresën në vijim:
http://www.nbrm.mk/materijali_fin_edu-al.nspx

BPRM-ja, përpos funksioneve të shumta në fushën e politikës monetare dhe sistemit bankar, ndërmerr aktivitete për të përmirësuar edukimin financiar përmes broshurave informative dhe materialeve edukative. Këto materiale janë në dispozicion përmes internet faqes së BPRM-së në pjesën e "edukimit financiar": https://www.nbrm.mk/materijali_fin_edu-al.nspx

Shërbimet kryesore bankare

Shërbimet kryesore bankare përfshijnë: llogaritë e transaksioneve dhe llogaritë e kursimeve.

Bankat në Republikën e Maqedonisë ofrojnë llogari transaksionesh dhe lloje të ndryshme të llogarive të kursimeve.

Me llogarinë e transaksioneve, njëjtë si me llogarinë e kursimeve punon dhe menaxhon një person, ai është pronar i llogarisë/ve dhe vetëm ai person, respektivisht vetëm pronari i llogarive, mund të autorizojë persona tjerë të punojnë me ato llogari.

Llogaria e transaksioneve

Llogari e transaksioneve është llogari për identifikimin e bartësit të llogarisë e cila mundëson të pranoni dhe të kryeni pagesa, për transferim të mjeteve nga njëra në një llogari tjetër të transaksionit, si dhe për transferimin e mjeteve në depozita të afatizuara. Llogaria e transaksioneve mund të hapet në të gjitha bankat në Republikën e Maqedonisë. Mund të keni më shumë se një llogari të transaksioneve në një ose më shumë banka.

Në çdo kohë mund të kryeni pagesa dhe depozitoni ose tërhiqni para të gatshme nga llogaria juaj e transaksioneve, kur të keni nevojë, deri në shumën e fondeve në dispozicion në llogarinë tuaj. Gjithashtu, mund të aplikoni për kartelë pagesore e cila mundëson kryerjen e transaksioneve në tregti (në vendet e shitjes ose përmes internetit) dhe të tërhiqni/depononi mjete nga/ në bankomate.



Si pronar i llogarisë së transaksioneve ju keni mundësi:

- Të parashtroni kërkesa lidhur me llogarinë (p.sh të merrni bilancin e llogarisë, qasje elektronike në llogari etj.);
- Të kryeni pagesë me para të gatshme në llogari;
- Të tërhiqni para të gatshme nga llogaria;
- Të kryeni transferim të parave brenda bankës së njëjtë;
- Të kryeni transferim të mjeteve financiar brenda bankës së njëjtë;
- Të paguani detyrimet (p.sh shpenzimet e përgjithshme etj.) dhe
- Të përdornin bankingun elektronik.

Llogaria e kursimeve

Llogaria e kursimeve është llogari depozituese e cila mund të hapet nëpër bankat dhe kursimoret e Republikës së Maqedonisë. Llogaritë e kursimeve janë llogari në të cilat fitohet interes për depozitat e investuara. Normalisht, ato janë të lidhura në një afat të caktuar kohor dhe mund të jenë afatshkurtra dhe afatgjata. Depozita minimale për llogarinë e kursimit, maturiteti, si dhe lartësia e normës së interesit varet nga banka, respektivisht dallojnë nga banka në bankë, njëjtë edhe te kurismoret.

Si pronarë i llogarisë së kursimeve ju keni mundësi:

- Të investoni depozita parash;
- Të tërhiqni mjetet pas skadimit të afatit të caktuar ose paraprakisht, varësisht nga kontrate e lidhur dhe kushte e përshkruara; dhe
- Të pranoni interes.

Normalisht nuk kryhen pagesa përmes llogarive të kursimeve. Pagesat kryhen përmes llogarive të transaksioneve.

Çka duhet të mbani mend për të dy llojet e llogarive - (të transaksioneve dhe kursimeve)

- Ruani numrin tuaj të llogarisë dhe mos e ndani me tjerë;
- Ruani raportet e llogarive, librezat e kursimeve dhe kartat e pagesave në një vend të sigurt;
- Ruani fjalëkalimin dhe emrin tuaj të përdoruesit nëse keni qasje elektronike në llogari dhe mos i ndani ato me tjerë; dhe
- Menjëherë informoni bankën nëse:
 - keni ndryshuar adresën ose numrin e telefonit;
 - keni humbur kartën e pagesave ose librezën e kursimit;
 - keni vërejtur mospërputhje në raportin tuaj bankar me transaksionet e realizuara.

Fondi i Sigurimit të Depozitave i Republikës së Maqedonisë institucion shtetëror i specializuar financiar i formuar me qëllim të sigurimit të depozitave të qytetarëve në bankat dhe kursimoret e Republikës së Maqedonisë dhe kompensimin e depozitave të siguruara nëpër banka, filialet e bankave të huaja dhe kursimoret, nëse tek ato ka ndodhur ndonjë ngjarje e rrezikshme.

Depozita nënkupton: depozita në denarë dhe në deviza (më lart të quajtura si llogari të kursimeve), certifikatat për depozitat, depozita të llogarive të transaksioneve, depozita të lidhura me kartat e parave dhe hyrje devizore të personave fizikë.

Fondi i kompenson depozitat e siguruara, por jo më shumë se 30.000 euro në kundërvlerë në denarë për depozitë në një bankë, filiale të bankës së huaj ose kursimore të llogaritura sipas kursit të mesëm të BPRM-së.

Me sigurimin e depozitave bankat, filialet e bankave të huaja dhe kurismoret, Fondi kontribuon në ruajtjen e stabilitetit dhe besimit të publikut në sistemin bankar dhe financiar në vend.

Në vende të dukshme në sportelet e bankave dhe kursimoreve ka njoftim për deponuesit me informacion se depozitat e personave fizikë në atë bankë ose kursimore janë të siguruara me Fondin për Sigurim të Depozitave.

Për më shumë informata vizitoni internet faqen e Fondit për Sigurim të Depozitave: <http://www.fodsk.org.mk>

Bankat dallojnë për nga kushtet e produkteve dhe shërbimeve të tyre. Njihuni me ato kushte. Gjithmonë bëni krahasim midis bankave dhe zgjedhni më të mirën për ju.

Kanale bashkëkohore për përdorim të shërbimeve bankare

Bankat në Republikën e Maqedonisë ofrojnë shërbime të ndryshme bankare përmes kanaleve alternative ose bashkëkohore - metoda të reja të kryerjes së operacioneve bankare me përdorimin e kanaleve elektronike interaktive. Këto kanale përfshijnë shërbime bankare përmes: Internetit, telefonit celular dhe SMS-ve, telefonit fiks, faksit dhe postës elektronike. Të gjithë kanalet përdoren për kontroll të bilancit të llogarisë dhe zakonisht tre të parat edhe për kryerjen e transaksioneve.

Bankingu përmes internetit dhe telefonit celular

Bankat në Republikën e Maqedonisë ofrojnë më shumë shërbime nga fusha e bankikut elektronik. Në të njëjtën kohë, rritet edhe interesi nga ana e klientëve, sepse bankingu elektronik paraqet mënyrë të shpejtë për kryerjen e transaksioneve bankare. Bankingu përmes internetit ka të bëjë me realizimin e transaksioneve bankare përmes faqes së sigurt të internetit të një banke. Bankingu përmes telefonit celular normalisht ka të bëjë me realizimin e transaksioneve bankare me përdorimin e aplikacionit të instaluar në celularin "e zgjuar" ose tabletin tuaj.

Bankingu përmes internetit dhe telefonit celular ka përparësi për ju si konsumator. Ju mund të realizoni transaksionet bankare nga shtëpia ose nga zyra, gjatë dhe jashtë kohës së punës së bankave dhe prej çdo vendi ku keni qasje në internet. Gjithçka që ju duhet është një kompjuter personal me shfletues interneti ose telefon "i zgjuar" me aplikacion celulari ose lidhje në internet. Në raste të caktuara nevojitet softuer ose harduer i caktuar, si për shembull: Token për fjalëkalim i vetëm namesto fjalëkalim të njehershëm (OTP-token) ose lexues i kartelës së "zgjuar".

Normalisht, bankat i ofrojnë këto shërbime bankare përmes kanaleve alternative:

- Kontroll i bilancit të llogarive në bankë dhe pasqyra për ato llogari;
- Parashtrimi i aplikacionit për hapje të llogarive të reja, kartave të debitit ose të kreditit dhe hua;
- Transferimi i mjeteve mes llogarive (personale dhe në banka tjera);
- Pagesa e detyrimeve në bazë të: llogarive, kartave të kreditit, kësteve të kredisë, prime për sigurim dhe të tjera; dhe
- Plotësimin, ndryshimin dhe tërheqjen e urdhrave të përhershme.



Përdoruesit regjistrohen në internet faqen e bankave të cilat ofrojnë shërbime elektronike bankare përmes dhënies së një së emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të vlefshëm. Gjithashtu, ndonjëherë mund të përdoren edhe PIN-kode ose OTP-tokena.

Regjistrimi në bankingun elektronik është pa kompensim nëse jeni klient i bankës. Tarifa të caktuara mund të ngarkohen për shërbime të caktuara siç janë transferimi ndërbankar i mjeteve. Kontrolloni tarifat në bankën tuaj. Bankat zakonisht ofrojnë kompensim më të ulët për përdorimin e bankingut elektronik në raport me kanalet tjera, siç janë shërbimet në sportel .

Internet bankingu i sigurt

Ekziston një shqetësim tek popullata për sigurinë e informacioneve (të dhënave) dhe për sigurinë e transaksioneve të kryera përmes internetit. Bankat vazhdimisht punojnë që bankingu elektronik të jetë një kanal i sigurt, por rreziqet gjithmonë ekzistojnë.



Kur klienti kryen transferim të mjeteve, bankat janë të detyruara të aplikojnë masa shtesë të sigurisë për kontroll të përdoruesit. Në raste të ndryshme mund të kërkohej edhe: nënshkrim dixhital, fjalëkalim i vetëm (OTP) ose numër për autorizimin e transaksionit (TAN-kod).

Për sigurinë tuaj, gjithmonë printoni çdo transaksion bankar të kryer përmes internetit.

Kjo do ju mundësojë të bëni krahasimin nëse ka mospërputhje me pasqyrën të cilën banka ua dërgon dhe do ju shërbejë t'i monitoroni të gjithë transaksionet e realizuara.

Keni të drejtë të kundërshtoni çdo internet transaksion të kryer nga ndonjë person tjetër në emrin tuaj. Banka është e detyruar t'ju dorëzojë provë për vlefshmërinë dhe parevokueshmërinë e transaksionit.

Në përgjithësi, internet bankingu ofron një mënyrë të sigurt për realizimin e transaksioneve bankare, por për sigurinë tonë është e domosdoshme të ndërmerren masat në vijim:

- Ruani në vend të sigurt: emrin dhe fjalëkalimin e përdoruesit, PIN-kodin, certifikatat digjitale, OTP-tokenat ose TAN-kodin;
- Kohë pas kohe ndryshoni PIN-kodet dhe fjalëkalimet tuaja;
- Mos e ruani emrin e përdoruesit, fjalëkalimin ose PIN-kodin në kompjuter, nëse nuk keni mbrojtje shtesë (p.sh bitlocker);
- Kontrolloni nëse jeni të paraqitur në internet faqen e duhur;
- Për tu siguruar se jeni në internet faqe të sigurt, lokatori universal i burimeve (URL) doemos të fillojë me "https", gjithashtu shihni nëse faqja ka simbolin e drynit të mbyllur në internet shfletuesin tuaj;

- Rregullisht shfletoni raportet bankare dhe historinë e transaksioneve;
- Mos e leni kompjuterin tuaj ndezur përderisa jeni të kyçur në internet faqe për përdorimin e bankingut elektronik;
- Gjithmonë çkyqeni në fund të sesionit dhe fshini historinë e internet shfletuesit kur të përdorni kompjuter publik;
- Mbroni kompjuterin personal nga viruset dhe programet e dëmshme me programet më të reja antivirus;
- Shmangni incizimin e datotekave (shtesave) ose softuerit prej internet faqeve të cilat nuk i njihni dhe shmangni hapjen e internet viruseve (lidhjeve) të cilat dërgohen prej personave të panjohur;
- Shmangni dërgimin e të dhënave personale (veçanërisht PIN-kodin tuaj) përmes mesazhit elektronik;
- Mbani mend se bankat asnjëherë nuk do ju kontaktojnë përmes mesazhit elektronik ose telefonit që të kërkojnë detajet e tuaja personale për regjistrim;
- Shmangni përdorimin e kompjuterëve të përbashkët ose publikisht të përdorur në internet salla (internet kafe) për përdorimin e bankingut elektronik;
- Mos leni paralelisht të hapur dritare tjetër (faqe tjetër të internetit) përderisa jeni të lidhur në bankingun elektronik;
- Ju këshillojmë të çaktivizoni ndarjen e dokumenteve dhe pajisjeve për printim (file and printer-sharing) në sistemin operativ të kompjuterit tuaj.



Gjithmonë ekziston mundësia që diçka të mos shkojë në rregull dhe të bëhet ndonjë gabim i caktuar. Nëse hasni çfarëdo lloj problemi, menjëherë paraqiteni në kontakt-qendrën e bankës për t'i lajmëruar problemet që i keni hasur. Banka juaj i regjistron të gjithë transaksionet tuaja dhe mund t'ju ndihmojë. Zakonisht, në anën e pasme të kartelës (debitit, kreditit) është shënuar numri i telefonit me të cilin mund të kontaktoni bankën në çdo kohë të ditës (24 orë/7 ditë në javë).

Lexoni dhe kuptoni kushtet për përdorim të bankingut elektronik ku jeni të regjistruar, veçanërisht pjesën që ka të bëjë me transaksione të pa-autorizuara ose të rrejshme dhe si të parashtroni një ankesë. Është mirë të takoni oficerin bankar që t'ju shpjegojë gjithçka që nuk e keni të qartë para se të përdorni bankingun elektronik.




Mbani mend

- Bankat ofrojnë produkte dhe shërbime të ndryshme bankare për të kënaqur nevojat e tua financiare.
- Merrni parasysh të gjithë rrethanat gjatë zgjedhjes së bankës në pajtim me nevojat tuaja.
- Depozitat e qytetarëve deri në 30.000 euro janë të siguruara në Fondi për Sigurim të Depozitave të Republikës së Maqedonisë.
- Internet bankingu paraqet mënyrë të favorshme, të shpejtë dhe të sigurt për realizimin e transaksioneve tuaja bankare.
- Internet bankingu është alternativë bashkëkohore e bankingut konvencional (tradicional).



Pjesa B

Realizimi i
ëndërrave tuaja



Në pjesën A diskutuam për atë nëse menaxhimi "i mençur" i parave ndikon pozitivisht mbi gjendjen tuaj financiare, gjegjësisht me kalimin e kohës do të keni më shumë pasuri sesa borxh. Në pjesën B, do të shkojmë një hap më tej në diskutim për atë si mund të krijoni pasurinë tuaj dhe si në të njëjtën kohë të planifikoni të ardhmen.

Shprehia për kursim

Kursim automatik

Plani për kursim është pjesë thelbësore e planit tuaj financiar. Pa plan për kursim sigurisht nuk do mund të realizoni qëllimet financiare. Ju sugjerojmë të kurseni të paktën 10% të të ardhurave mujore. Akoma më mirë është nëse mundeni të kurseni 20-30%, kjo do të thotë më shumë para për të ardhmen. Mos harroni se sa më shumë kurseni tani, aq më e lehtë do të jetë të arrini qëllimet tuaja financiare nesër.



Ekzistojnë dy mënyra për të kursyer këtë përqindje nga të ardhurat mujore.

Ju mund:

- çdo muaj të depononi mjete në llogarinë tuaj të kursimit, bankë ose në kursimore; dhe
- çdo muaj përmes bankikut elektronik të transferoni para nga llogari juaj e transaksionit në llogarinë tuaj të kursimit.

Është mirë nëse këtë e bëni në bazë të rregullt mujore. Por, nëse pas disa muajsh, harroni të depononi mjete ose gjeni arsye për të përdorur paratë nga llogaria e kursimit për diçka tjetër, me atë do të thyni modelin e kursimit dhe mund të mos ktheheni në planin tuaj për kursim.

Si të siguroheni se do të ruani planin tuaj për kursim? Thjeshtë - bëjeni atë automatikisht!

Kërkoni nga banka të kryej transferim të së paku 10% të të ardhurave tuaja mujore nga llogaria juaj e transaksionit në llogarinë tuaj të kursimit. Banka të kryej procesin menjëherë pas pagesës së të ardhurave në llogarinë tuaj të transaksionit.

Ndërkohë, shuma e parave në librezën tuaj të kursimit do të vazhdojë të rritet, dhe me kalimin e kohës do t'ju afrojë afër qëllimeve financiare.

Kur të mund të përballoni (për shembull ju kanë rritur rrogën) udhëzoni bankën të rrisë shumën të cilën duhet të transferojë në llogarinë tuaj të kursimit.

Kur të siguronit shumën totale të parave që keni planifikuar të kurseni, transferoni shumën e tërë në depozitë në bankë ose në llogari tjera të cilat mund të kenë kthim më të madh.



Është mirë që asnjëherë të mos ndaloni së kursyeri që të mos ndërpritni shprehinë e fituar. Paratë të cilat "i kurseni automatikisht" mund të përdoren për realizimin e qëllimeve tjera financiare.

Zmadhimi i pasurisë tuaj

Krijimi i pasurisë është rritja e neto vlerës tuaj (shih pjesën 2). Dallimi i mjeteve dhe detyrimeve tuaja është i barabartë me neto vlerën tuaj, e cila mund të jetë pozitive (më shumë mjete se detyrime) ose negative (më shumë detyrime se mjete). Në këtë kapitull, do të fokusohemi në rritjen e mjeteve tuaja përmes kursimit dhe investimeve.

Qëllime investuese

Pasi të keni kursyer rregullisht, do të duhet të filloni të merrni vendime të rëndësishme për atë se si të investoni paratë tuaja. Si investohet? Përgjigja është: lehtë. Mund të investoni paratë në mënyrë të arsyeshme, por fillimisht duhet të specifikoni qëllimet tuaja investuese.

Do t'ju ndihmojmë të identifikoni qëllimet investuese që u përshtaten nevojave tuaja.

Ekzistojnë disa pyetje kyçe për të cilat duhet të konsiderohen gjatë formimit të qëllimeve tuaja investuese. Le ti shqyrtojmë më poshtë:



- Pse duhet të ruani paratë tuaja? A mendoni të investoni në të ardhmen?
- Nëse planifikoni të investoni, sa para do ju duhen për të arritur qëllimet tuaja?
- Sa kohë do duhet të kurseni ose investoni para për të arritur qëllimet tuaja?
- Sa është rreziku të cilin jeni të gatshëm ta ndërmerrni?
- Sa kthim pritni nga kursimet ose investimet tuaja?

- Për çka jeni të përgatitur për të arritur qëllimet? (shembull ndryshim i mënyrës së jetesës dhe shprehive për shpenzim).

Bëhuni realist kur të përgjigjeni në pyetjet më lartë. Llogaritni burimet tuaja të të ardhurave dhe shihni me çfarë shume të përhershme mund të kurseni dhe të investoni.

Një gjë është e sigurt, qëllimet dhe investimet tuaja financiare duhet të jenë të arsyeshme dhe të realizueshme.

Rreziku dhe kthimi i investimeve

Ruajtja e parave tuaja në llogari të kursimeve në një bankë ose kursimore është forma më e sigurt e investimeve. Fitimi (gjegjësisht norma e interesit) ndoshta është i vogël në krahasim me disa forma të ndryshme të investimit, por edhe më pak i rrezikshëm.



Kuptohet, nëse i ruani paratë vetëm si depozita, nuk mund të rritni pasurinë tuaj aq shpejt sa dëshironi. Keni parasysh se format tjera të investimeve mund t'ju japin rezultate më të mira, por ato bartin rreziqe më të mëdha, respektivisht ekziston mundësia investimet e këtilla ta humbin vlerën e tyre.

Për shembull, nëse i investoni paratë tuaja në bursë, do të ballafaqoheni me mundësinë për fitim të lartë, por edhe rrezik që t'i humbni ato. Domethënë, çmimet e aksioneve lëvizin lartë e poshtë, në varësi të shumë faktorëve. Për shembull, të themi se i keni blerë aksionet e një kompanie në shumë prej 1.000 denarë për aksion, kjo nuk është konstante, mund të zmadhohet në 3.000 denarë ose mund të zvogëlohet në 700 denarë për aksion.



Kur investon para, është e rëndësishme të keni kthim nga ato para.

Megjithatë, kthimi i vërtetë i investimit do të jetë i ditur pasi të hiqen të gjitha shpenzimet. Domethënë, do të zbuloni kthimin tuaj të plotë vetëm pasi të hiqni shpenzimet siç janë provizionit i ndërmjetësuesit.

Kthimi i investimit (yield-i) zakonisht shprehet si përqindje vjetore. Nëse blini aksione me çmim prej 1.000 denarë dhe çmimi rritet në 1.080 denarë pas një viti, atëherë norma e juaj e kthimit është 8%.

Gjatë zgjedhjes së investimit tuaj, sa më i madh kthimi, aq më i madh rreziku.

"Mos i vendosni të gjithë vezët në një shportë"

Çka do të ndodhi nëse i vendosni të gjithë vezët në një shportë dhe e lëshoni prej dore? Është shumë e sigurt se të gjithë vezët do të thyhen. Ngjashëm, nëse i investoni paratë në një vend dhe nëse ndodh diçka e pafavorshme me atë investim, do të humbni të gjithë paratë menjëherë.



Prandaj, është shumë e rëndësishme të diversifikohet investimi, gjegjësisht të investoni para në lloje të ndryshme të investimeve. Me fjalë të tjera, planifikoni portofol të balancuar të investimeve. Diversifikimi i parave në investime të ndryshme është çelësi i zvogëlimit të rreziqeve.

Në çfarë mënyre investoni është pjesërisht e përcaktuar nga profili i juaj si investitor, gjegjësisht nëse jeni investitor agresiv, i matur ose i konservuar.

Nëse jeni investitor i matur, me siguri do i renditni paratë në instrumentet të llojeve të ndryshme ose në investim me të ardhura fikse siç janë depozitat.

Shumën që e investoni në instrumente financiare mund më tej ta ndani në lloje të ndryshme të letrave me vlerë.

Nëse jeni investitor agresiv, me siguri do të investoni në investime me më shumë kthim, por edhe më të rrezikshme.

Nga ana tjetër, nëse jeni investitor konservativ, me siguri do të mendoni për diversifikim të parave tuaja midis investimeve me më pak kthim dhe me më pak rrezik siç janë obligacionet (obligacionet shtetërore) dhe depozitat. Nuk ekzistojnë dy investitorë të cilët janë plotësisht të njëjtë në investim! Ju jeni të vetmit të cilët mund të vendosni cilat opsione do t'i miratoni nga llojet e shumta të alternativave investuese që i keni në dispozicion.

Llojet e investimeve

Investime me interes fiks (depozita)

Forma më e shpeshtë e investimit te popullata e Republikës së Maqedonisë janë depozitat bankare.

Bankat sigurojnë qasje të lehtë deri te paratë tuaja kur ju duhen dhe kthim të sigurt (veçanërisht me normë fikse të interesit dhe inflacion të ulët dhe stabil).



Megjithatë, depozitat bankare zakonisht sigurojnë kthim më të ulët në krahasim me alternativat tjera investuese.

Tregu i letrave me vlerë

Ekzistojnë lloje të ndryshme të letrave me vlerë aksione të emetuara prej shoqërive aksionare dhe shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, aksione në fonde investuese, obligacione, letra me vlerë në tregun e parasë, instrumente financiare derivative dhe instrumente tjera financiare të cilat sipas Komisionit për Letra me Vlerë llogariten si letra me vlerë.

Aksione

Aksionet janë letra me vlerë të kapitalit të cilat paraqesin një pjesë të padukshme dhe ideale nga kryegjëja bazë e shoqatës aksionare.

Aksionet përfaqësojnë pronësi në atë shoqatë. Kur të blini një aksion, do të fitoni një pjesë të shoqatës dhe do të keni të drejtë të merrni pjesë në profitin e saj. Aksionet në shoqatë e rrisin vlerën e investimit tuaj në dy mënyra:

- Me rritjen e vlerës totale të shoqatës rritet edhe vlera e aksioneve, gjë që mundëson realizimin e fitimit kapital; dhe
- Mund të fitoni kthim në formë të dividendave kur shoqata do të vendosi tu paguaj aksionarëve pjesë nga profiti i saj.

Aksionet kanë potencial të japin kthim shumë të lartë. Megjithatë, ata, gjithashtu, kanë potencial të zvogëlojnë vlerën, nëse efikasiteti i shoqatës zvogëlohet.

Pronarët e aksioneve kanë disa të drejta bazë:

- të drejtën e votës në asamblenë aksionare;
- të drejtën e dividendës, si pjesë e fitimit të shoqatës dhe
- të drejtën e pjesës së pasurisë së falimentimit, në rast të likuidimit të shoqatës.

Aksionet zakonisht janë të përshtatshme për investitorë të cilët:


- Duan të ndërtojnë portofol (kombinim të letrave të ndryshme me vlerë) për realizimin e qëllimeve financiare afatshkurtra dhe afatgjata;
- Kanë mundësi të investojnë për një periudhë më të gjatë kohore; dhe
- Pranojnë jostabilitetin e vlerës së tyre në afat të shkurtër, në zëvendësim të kthimit më të lartë në afat të gjatë (në bazë të kthimit prej dividendave dhe fitimit kapital).

Obligacione

Obligacionet janë letra afatgjate me vlerë të borxhit, me të cilat emetuesi lidhet të paguaj interes, njëherë ose në këste, pronarit të obligacionit dhe ta paguaj në ditën e caktuar shumën e vlerës nominale të obligacionit. Respektivisht, kur do të blini obligacion shtetëror ose korporativ, ju i "merrni hua" paratë tuaja për një periudhë me normë interesi paraprakisht të përcaktuar.

Në kthim, fitoni të ardhura të vazhdueshme përmes pagesave të rregullta të interesit.

Njëjtë si me aksionet, ashtu edhe me obligacionet mund të tregtohet në tregjet financiare.



Shtëpitë e brokerimit

Transaksionet e shitblerjes së letrave me vlerë, zhvillohen përmes shtëpive të brokerimit/bankave të autorizuar, me leje për punë si shtëpi brokerimi e marrë nga organi rregullatorë (Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë), të cilat janë anëtare të organizatave vetë-rregullatore në pajtim me ligjin (bursa e autorizuar dhe depozitar i autorizuar).

Brokera

Brokerat janë persona të autorizuar nga organi rregullatorë (Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë) dhe të licencuar nga Bursa Maqedonase, të cilët kryejnë shërbime lidhur me përmbarimin e urdhrave të klientëve, informimin e klientëve për blerje ose shitje të letrave me vlerë, gjë që nuk nënkupton këshillë investuese.

Gjatë punës së tij, brokeri duhet rreptësisht t'u përmbahet udhëzimeve të dhëna nga klienti, të punojë me ndërgjegje dhe profesionalizëm, duke pasur parasysh qëllimet investuese dhe gjendjen financiare të klientit dhe të respektojë aktet e organizatës vetë-rregullatore ku merr pjesë.

Këshilltari investues është personi i autorizuar nga ana e organit rregullatorë i cili kryen shërbime lidhur me këshillim investues të klientit.

Bursa Maqedonase

SHA „Bursa Maqedonase“ Shkup është themeluar në vitin 1995 dhe është bursa e parë e organizuar e letrave me vlerë në historinë e Republikës së Maqedonisë. Është themeluar si shoqatë aksionarësh, në bazë jofitimprurëse, nga ana e 19 bankave dhe institucioneve tjera financiare (13 banka, 3 shoqata sigurimesh dhe 3 kurismore) dhe ato ishin anëtarët e saj të para në tregtinë e Bursës. Zilja e bursës në Bursën Maqedonase jehoi për herë të parë më 28 mars të vitit 1996 dhe me të shënoi fillimin zyrtar të tregtisë. Në vitin 2001, Bursa filloi të punojë në bazë fitimprurëse, ndërsa aksionar në bursë mund jetë cilido person fizik ose juridik i vendit ose i huaj. Në të njëjtin vit, Bursa prezantoi tregtinë elektronike me letra me vlerë - Sistem Elektronik i Bursës për Tregti (BEST) dhe kështu u krijuan kushte për rritjen e vëllimit, efikasitetit dhe likuiditetit të tregtimit të bursës. Bursa, brenda punës saj i kryen aktivitetet në vijim, përmes të cilave siguron:

- mbledhjen e ofertave për blerje dhe shitje të letrave me vlerë,
- formimin e tregut të çmimeve të letrave me vlerë me të cilat tregtohet në Bursë,
- lidhjen e transaksioneve me letra me vlerë,
- vërtetimin dhe raportimin mbi transaksionet e përfunduara me letra me vlerë,
- respektimin e rregullave të rregullave dhe standardeve të Bursës, rregulloreve të Ligjit të Letrave me Vlerë dhe rregullore tjera të anëtarëve të Bursës.
- mbrojtjen e interesave të investitorëve të letrave me vlerë,
- pranimin të letrave me vlerë për tregti në Bursë, duke përfshirë kuotimin dhe letrat me vlerë,
- informimin e publikut për çështjet e rëndësishme në lidhje me punën e Bursës etj.

"Depozitari Qendror i Letrave me Vlerë"

Si person juridik, „Depozitari Qendror i Letrave me Vlerë” SHA Shkup është themeluar në vitin 2001, nga ana e 10 shoqatave të brokerimit, 14 bankave dhe një kompanie sigurimesh. Në pajtim me Ligji i Letrave me Vlerë, për kryerjen e funksioneve të tij, Depozitari mori Pëlqim për themelim dhe punë nga ana e Komisionit për të Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë. Deri në themelimin e Depozitarit, letrat me vlerë të emetuara në Republikën e Maqedonisë bëheshin në formë letre, gjë që për emetuesit, bursën, brokerët dhe pronarët ishte një proces i komplikuar i emetimit, tregtimit dhe regjistrimit të pronësisë mbi letrat me vlerë. Pas themelimit të Depozitarit, gjatë fundit të nëntorit të vitit 2001, filloi procesi i dematerializimit gjegjësisht konvertimit të letrave me vlerë prej formës materiale në elektronike, me çka Depozitari e fitoi rolin e bazës qendrore të të dhënave përmes së cilës bartësve të letrave me vlerë, investitorëve, institucioneve kompetente edhe subjekteve tjera të prekura, në mënyrë të shpejtë dhe të thjeshtë u sigurohet qasje deri te të dhënat e nevojshme.

Procesi i dematerializimit dhe qasja e centralizuar për evidencë të të gjithë letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë e zmadhoi mbrojtjen e të drejtave të investitorëve dhe përmirësoi besimin në tregun maqedonas të kapitalit.

Funksionet e Depozitarit në pajtim me Ligji i Letrave me Vlerë janë:

- regjistrimi i emetimit dhe kthimit të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë në formë të regjistrimit elektronik (mbajtja e regjistrit të letrave me vlerë);
- dhënia e numrit ndërkombëtar të identifikimit të letrave me vlerë (ISIN) për të gjithë emetimet e letrave me vlerë;
- regjistrimi i pronarëve të letrave me vlerë;
- shlyerja e transaksioneve tregtare sipas parimit "dorëzim kundrejt pagesës";
- kryerja e kthimeve jotregtare (realizimin e kontratave për dhuratë, trashëgim, vendime tjera gjyqësore etj);
- sigurimi i kushteve për huamarrje të letrave me vlerë;
- monitorimi i gjendjes financiare të anëtareve të tij me qëllim menaxhim të rrezikut lidhur me mosshlyerjen e mundshme të transaksioneve tregtare dhe
- shërbime shtesë për emetuesit e letrave me vlerë.

Fonde investuese

Fondi investues si formë profesionale e menaxhimit të investimit u themelua me qëllim bashkimin e mjeteve të personave fizikë ose juridikë të vendit ose të huaj, të cilat pastaj investohen në tregun e kapitalit në letra të ndryshme me vlerë; aksione, obligacione etj. Me mjetet e fondit menaxhon Shoqata për Menaxhim me Fondet Investuese (SHMFI).

Çdo investitor pastaj fiton "pjesë" në fond, çdo pjesë paraqet përzierje të instrumenteve të ndryshme financiare që fondi i ofron, siç janë aksionet, obligacionet dhe depozitat.

Fondi investues mund të jetë: Fond investues i hapur, fond investues i mbyllur dhe fond investues privat.

Përparësitë e investimit në fonde investuese në raport me investimin e drejtpërdrejtë në letra me vlerë janë:

- Shpërndarja e rrezikut - fondet investojnë në një numër të madh të letrave me vlerë, gjë që e zvogëlon rrezikun gjatë investimit;
- Menaxhimi profesional - investitorët individual rrallë kanë kohë, njohuri dhe dëshirë që në bazë ditore të analizojnë një numër të madh të letrave të ndryshme me vlerë dhe pavarësisht të marrin vendim për investime. Në anën tjetër, fondet investuese disponojnë me kuadro profesionale dhe me përvojë të cilët çdo ditë analizojnë tregtinë në tregjet e letrave me vlerë. Në fakt, dallimi më i madh mes investitorëve individualë dhe institucionalë qëndron tek ekspertiza; dhe
- Likuiditeti - të gjithë investitorët në fonde të hapura investuese mund në çdo moment të parashtrojnë kërkesë për shitje të pjesës së tyre në fond. Në të kundërtën, gjatë investimit të drejtpërdrejtë në aksione, gjithmonë ekziston rreziku që pronari të mos jetë i aftë të shesë aksionet si pasojë e likuiditetit të ulët në treg për ato aksione.

Fondet investuese janë mundësi ideal për njerëz të cilët:

- janë të rinj në investim;
- vendosin të zhvendosin zgjedhjen e investimeve tek portfolio-menaxherët profesional;
- kanë shumë të vogël fillestare për investim;
- kërkojnë diversifikim të investimeve për të minimizuar rrezikun.

Patundshmëri

Pjesa më e madhe e popullatës është e njohur me investimet në patundshmëri. Investimi në patundshmëri ofron vlerë për investorët në dy mënyra:

- Zmadhimi i vlerës së kapitalit me kalimin e kohës me rritjen e çmimeve të shtëpive dhe tokës (dhe anasjelltas); dhe
- Të ardhurat nga qiratë.



Njëjtë si aksionet, edhe çmimet e pronës mund të lëvizin lart dhe poshtë, por prona zakonisht është e përshtatshme si një investim afatgjatë. Një nga faktorët më të rëndësishëm që duhet të merret parasysh kur blihet një pronë është lokacioni i saj.

Disa nga karakteristikat e mashtrimit financiar janë:

- Nuk kanë nevojë për qasje "emergjente" deri te paratë e tyre;
- Investojnë në plan afatgjatë; dhe
- Janë të aftë t'i përmbushin pagesat e anuitëve të kredive nëse rriten normat e interesit ose nëse prona nuk është dhënë me qira.

Mashtrime financiare

Kur i investoni paratë tuaja, duhet të jeni shumë të kujdesshëm që të mos pësoni nga mashtruesit financiar. Zakonisht, ata premtojnë se ju do të merrni një kthim të lartë të parave me rrezik shumë të ulët. Ata, gjithashtu, ju bindin se nuk ka nevojë për aftësi, kohë ose përpjekje për të fituar kthim të lartë, ose mundet të pasuroheni duke „qëndruar në shtëpi“ në mënyrë të shpejtë dhe të lehtë.



Mënyrat e këtilla të pasurimit të shpejtë shpesh reklamohen nëpër revista, gazeta dhe media tjera, dhe gjithashtu promovohen edhe në internet përmes e-mailit dhe spam-porositve dhe ofrohen përmes paraqitjeve drejtpërsëdrejti në telefon ose përmes SMS-it.

Disa nga karakteristikat e mashtrimit financiar janë:

- Premtim i kthimit të lartë prej 20-30% në muaj me rrezik të ulët ose pa rrezik;
- Ofertë speciale për një periudhë të kufizuar kohore vetëm për t'ju mashtruar që të regjistroheni menjëherë;
- Ofertë për punë në një vend tjetër, por ju nuk mund të vërtetoni statusin e firmës e cila e ofron punën në cilindo organ rregullator; dhe
- Kërkesë për dhënien e informacioneve konfidenciale, siç janë numri i llogarisë suaj të transaksioneve, letërnjoftimit, pasaportës etj.

Çka duhet të bëni kur të hasni ndonjë ofertë atraktive për pasurim të shpejtë?

- Rregulli i artë është të mos jemi lakmitar dhe të shmangni marrjen e vendimeve të përshpejtuara momentale. Gjithmonë kontrolloni me miqtë, familjen dhe profesionistët nëse mundësitë e këtilla për investim janë të vërteta ose jo;

- Mësoni më shumë për ofertën përpara se të vendosni të investoni. Kujdes nga investimet të cilat ofrojnë kthime të larta, rrezik të ulët dhe pa shpenzime investuese, pasi që nuk ka gjasa që një biznes të mund të sigurojë të gjitha këto përparësi;
- Edhe nëse oferta investuese është e prezantuar ose rekomanduar nga dikush të cilin shumë mirë e njihni ose është anëtarë i familjes, gjithmonë duhet të konsideroni qëllimin pas ofertës, sepse nuk ka investim të lehtë i cili mund shpejt të sigurojë shumë para; dhe
- Bëhuni plotësisht të vetëdijshëm se investimi i paligjshëm nuk është lloji i investimit që dëshironi ta bëni. Një investim i tillë është më shumë se i rrezikshëm dhe do ju do të akuzoheni për investim të paligjshëm.



Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë (KLV)

Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë është organ i pavarur rregullator i cili kryen autorizimet publike të përcaktuar në Ligji i Letrave me Vlerë, Ligji i Fondeve Investuese, Ligjin për Marrjen e Shoqatave Aksionare dhe të gjithë aktet nënligjore, të cilat dalin nga ato.

Prioriteti kryesorë i KLV-së është një treg i letrave me vlerë i cili është fort i rregulluar, transparent dhe shumë i zhvilluar, integriteti i lartë i të cilit është garanci e besimi për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e kapitalit brenda vlerave të tij.

KLV-ja mbron të drejtat dhe interesat e investitorëve, dhe veçanërisht investitorëve të vegjël, që përfaqëson kusht themelorë për përmirësimin e klimës investuese në vend.

Në operacionet e përditshme, KLV-ja ndërmerr një sërë aktivitete për arritjen e qëllimeve të mëposhtme:

1. Përmirësimin e përdorimit të burimeve në tregun e letrave me vlerë, si burimi i mjeteve financiare për kompanitë;
2. Krijimin e infrastrukturës kompatible të tregut, duke pasur parasysh kërkesat e investitorëve të mundshëm dhe pjesëmarrësve të autorizuar të tregut;
3. Rritjen e nivelit të transparencës dhe aplikimi i rregullave dhe praktikave për sipërmarrësi të mirë nga ana e kompanive maqedonase, si dhe të gjithë pjesëmarrësve të autorizuar në treg.
4. Përf forcimin dhe thellimin e bashkëpunimit me rregullatorët në rajon me qëllim arritjes së qëllimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta.
5. Rritjen e ndërgjegjes dhe kulturës financiare të popullatës në RM-së përmes organizimit të trajnimeve, përgatitjes së udhëzuesve, broshurave;
6. Zbatimin efikas dhe efektiv i rregullores së re ligjore në fushën e tregut të letrave me vlerë të harmonizuar me direktivat evropiane etj.

Mbani mend

- Me qëllim që të pasuroheni filloni të kurseni menjëherë dhe investoni me mençuri.
- Duhet të rritni neto mjetet tuaja me qëllim që të rritni neto vlerën tuaj.
- Diversifikoni investimet tuaja me qëllim që të shpërndani dhe zvogëloni rreziqet.
- Sa më i madh kthimi i investimit, aq më i madh rreziku.
- Keni kujdes me ofertat për t'u pasuruar shpejt.



Pse nevojitet sigurimi?

Sigurohemi që të mbrojmë veten dhe të tjerët nga humbjet materiale dhe jomateriale. Qëllimi i sigurimit është të transferojë rrezikun i cili mund të shkaktojë dëm material ose jomaterial nga individit ndaj siguruesit (kompanisë së sigurimit).



Ç'është sigurimi?

Kur keni detyrim financiar, siç janë blerja e shtëpisë/banesës me kredi bankare, ju "rezervoni" një pjesë të të ardhurave tuaja të të ardhmes. Nëse ndodh ndonjë aksident (invaliditet) ose krijohet ndonjë situatë e pafavorshme ekonomike për ju, aftësia e juaj për të përmbushur detyrimet financiare zvogëlohet dhe mundësia të humbni pasurinë e fituar bëhet realitet.

Me qëllim që të mbroheni nga kjo dhe lloje të tjera të humbjes, ekziston një instrument financiar të cilin mund ta blini dhe quhet sigurim. Sigurimi është mjet i cili mundëson mbrojtje në rast se juve dhe familjes tuaj ose pasurisë tuaj të tundshme dhe të patundshme i ndodh diçka e padëshirueshme (objekte personale, shtëpi, banesë, veturë etj). Sigurimi blihet duke lidhur një kontratë sigurimi (polisë).

Si funksionon sigurimi?

Të gjithë të siguruarit e paguajnë primin e tyre në një fond të përbashkët në shoqatën e sigurimit. Sa më shumë të siguar të ketë shoqata e sigurimeve, aq më i madh është fondi i përbashkët. Gjithmonë kur një klient i caktuar do të kërkojë pagesë për dëmin, pagesa bëhet nga fondi i përbashkët. Prona juaj është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme të humbjes (zjarri, përmytjet, aksident në komunikacion, vjedhje etj). Çmimi për sigurim, gjegjësisht primi varet nga vlerësimi i rrezikut në pajtim me kushtet për sigurim të përcaktuara nga shoqata e sigurimeve.


Produktet e sigurimit

Produktet e sigurimit ndahen në dy grupe themelore:

- sigurimi i jetës
- sigurimi jo-jetë

Sigurimi i jetës

Sigurimi i jetës është mbulim me të cilën siguruasi angazhohet, t'i paguaj të siguruarit (përdoruesit të sigurimit), në bazë të primeve të paguara të sigurimit, shumën e siguar në rast të vdekjes, përjetimit ose paraqitjes së sëmundjeve të rënda. Ky sigurim ju mbron juve, fëmijët tuaj dhe prindërit ose anëtarët tjerë të familjes. Periudha e mbulimit zakonisht është më shumë se një vit dhe kenë zgjedhje që primin ta paguani në bazë mujore, tremujore, gjysmë-vjetore ose vjetore, përderisa kontrata e sigurimit është e vlefshme.



Produktet kryesore të sigurimit të jetës janë: sigurimi në rast vdekjeje (sigurim i rrezikshëm), sigurimi në rast përjetimi, sigurimi në rast vdekjeje dhe përjetimi (sigurim i përzier), sigurim i përjetshëm në rast vdekjeje, sigurim i anuitetit, sigurim me rrezik investues (sigurim i jetës në lidhje me aksione në fonde investues), sigurim me kthim të primeve etj.

Çka është e rëndësishme kur lidhni një kontratë për sigurimin e jetës?

- Nëse lidhni një kontratë për sigurimin e jetës ku i siguruari është palë e tretë, atëherë nga personi i tretë kërkohet pëlqim me shkrim për vlefshmërinë e kontratës.
- Për jetën e një personi mund të lidhen më shumë kontrata për sigurim të jetës me sigures të ndryshëm dhe kështu përdoruesi ka të drejtë të pagesës së shumave të siguruara në bazë të secilës prej tyre, në pajtim me kontratat e lidhura për sigurim.
- Personat me situatë të përkeqësuar shëndetësore mund të sigurohen nën kushte të veçanta të sigurimit.
- Gjatë lidhjes së kontratës për sigurimin e jetës, gjithmonë duhet të jeni të sigurtë gjatë plotësimit të pyetësorëve të cilat ju jepen. Përgjigja juaj e sigurtë është thelbësore për:
 - përcaktimin e mbulimit i cili plotësisht do të përmbushë nevojat e juaja për sigurim;
 - përcaktimi i primit real për atë mbulim;
 - shmangja e pasojave të padëshiruara sa i përket pagesës së shumës së siguruar, nëse në të ardhmen vërtetohet se informatat e dhëna në pyetësor nuk janë të besueshme.
- Mjetet të cilat, në formë të primi, të siguruarit ua besojnë shoqatave për sigurimin e jetës, shoqatat i investojnë në plasmanë të sigurta dhe të parrezikshme. Investimi i mjeteve i nënshtrohet kontrollit të posaçëm nga ana e Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.
- Të siguruarit me sigurim jetësor, në rastet me kushte të caktuara të sigurimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në përfitimin të cilin shoqatat e sigurimeve e realizojnë nga investimet e mjeteve të mbledhura përmes primit për sigurim.

Sigurimi blihet për mbrojtje nga aksidentet që mund t'ju ndodhin juve ose të afërmive tuaj, në mënyrë që të mos ju sjellin në vështirësi financiare.

Sigurimi jo-jetë

Kontratat e sigurimit të cilat nuk i përkasin grupit të sigurimit të jetës quhen kontratat për sigurim jo-jetë.

Produktet kryesore të sigurimit jo-jetë janë: sigurim i detyrueshëm në komunikacion (më i zakonshëm është sigurimi nga autopërgjegjësia), sigurimi i mjeteve motorike, sigurimi i shtëpisë, sigurimi i udhëtimit, sigurimi i sendeve personale, sigurim nga pasojat e aksidentit, sigurim shëndetësor, sigurim i përgjegjësisë etj..



Detyrimi për të raportuar dëmin

I siguruari, pasi ka mësuar se ka ndodhur ndonjë dëm (rasti i siguruar), është i detyruar të njoftojë shoqatën e sigurimeve e cila jep instruksione për procedurën e mëtejme në raport me përpunimin dhe pagesën e dëmit të raportuar. Personi i dëmtuar është çdo person i cili ka pësuar dëme të natyrës materiale ose jomateriale dhe i cili ka të drejtë të parashtrojë kërkesë dëmi deri te shoqata e sigurimit e cila është përgjegjëse për pagesën e dëmit të shkaktuar.

Nëse gjendeni në vendin dhe momentin e shkaktimit të dëmit, duhet të ndërmerrni masa për zvogëlimin e dëmit të shkaktuar, respektivisht të ndaloni zmadhimin e dëmit.

Gjatë raportimit të dëmit, siguroni dhe dorëzoni të gjithë dokumentet e nevojshme deri te shoqata e sigurimeve me qëllim të përcaktimit të drejtë, vendimmarrjes dhe pagesës së dëmit.

Detyrimi për pagesë të dëmit

Gjatë shkaktimi të dëmit (rastit të siguruar), shoqata e sigurimeve është e detyruar të paguaj shumën e siguruar, përkatësisht të paguaj kompensim ndaj të siguruarit në pajtim me kontratën për sigurim.

A janë të drejtat dhe interesat tua të mbrojtura në mënyrë adekuate?

Nëse llogaritni se shoqata e sigurimeve nuk funksionon në përputhje me dispozitat e policës së sigurimit, ju keni të drejtë të parashtroni një apel ose ankesë drejtuar

- Shoqatës së sigurimeve (siguruesit),
- Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve
- Organizata për Mbrojtjen e Konsumatorëve.



Keni të drejtë të parashtroni ankesë drejtuar Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve vetëm nëse paraprakisht keni kontaktuar shoqatën me shkrim, dhe nuk jeni të kënaqur me përgjigjen, ose nëse shoqata e sigurimeve nuk ka marrë vendim në lidhje me ankesën në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimt të saj.

Shoqata e sigurimit është e detyruar, para lidhjes së kontratës dhe gjatë kohëzgjatjes së kontratës për sigurim, t'i sigurojë të siguruarit të gjithë informacionet në lidhje me sigurimin në fjalë, si dhe detyrimisht të njoftojë nëse ka bërë ndryshime në kushtet për sigurim, ndryshime të zyrave të shoqatës ose njoftime tjera në pajtim me ligjin. Në rast të apeleve dhe ankesave nga personat e siguruar, shoqata detyrimisht duhet të njoftojë parashtruesin për rezultatet.

Para lidhjes së kontratës, shoqata e sigurimeve është e detyruar në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të ndershme, t'i sigurojë konsumatorit informata të sakta, të plota, të kuptueshme dhe të dobishme në lidhje me objektin e kontratës së sigurimit, karakteristikat e produktit ose shërbimit, ta njoftojë me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për sigurimin, pagesën e detyrimeve, si dhe të gjithë informacionet tjera të kërkuara nga konsumatori, gjegjësisht i siguruari.

Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve

Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Republikën së Maqedonisë është organ i pavarur rregullatorë i cili kryen autorizime publike të përcaktuara me Ligjin e Mbikëqyrjes të Sigurimeve. Roli i AMS-së ka për qëllim përforcimin e pozitës solvente të shoqatave të sigurimeve, rritjen e transparencës në punën e tyre, në kuadër të kompetencave të tyre dhe përmes anëtarësisë në shoqatat ndërkombëtare nga fusha e sigurimit dhe bashkëpunimit me organe tjera mbikëqyrëse.

Kompetencat e AMS-së kanë të bëjnë me:

- kryerjen e mbikëqyrjes mbi kompanitë e sigurimit, kompanitë ndërmjetësuese të sigurimit, kompanitë për përfaqësim në sigurim, ndërmjetësuesit e sigurimit dhe përfaqësuesit, personat juridikë të cilët janë të lidhur me kompanitë e sigurimeve dhe Byronë Kombëtare për Sigurim;
- dhënia ose marrja e licencave, dhënia ose tërheqja e pëlqimeve, heqja e paligjshmërisë nga mbikëqyrjet e kryera dhe çështje tjera individuale;
- shqiptimi i masave ndaj kompanive të sigurimeve, kompanive ndërmjetësuese-sigurimi, kompanive për përfaqësim në sigurim dhe personat të tjerë juridikë dhe fizikë në pajtim me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimit;
- mbrojtja e të siguruarve, përdoruesve të sigurimit dhe palëve te treta të dëmtuara dhe trajtimi i ankesave;
- zhvillim i sigurimit në Republikën e Maqedonisë;
- ngritje të vetëdijes publike për rolin e sigurimit dhe rolin e mbikëqyrjes së sigurimit dhe zmadhim i kulturës financiar dhe gjithëpërfshirjes.

Më shumë informacione mund të merren në internet faqen www.aso.mk

Informacione të dobishme për sigurimin

Ku mund të blini kontratë për sigurim (policë)?

- Kompanitë e sigurimit,
- Kompanitë ndërmjetësuese të sigurimeve,
- Kompanitë për përfaqësim në sigurim,
- Përfaqësues në sigurim,
- Banka - përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar.

Blerja e kontratës për sigurim është një vendim shumë i rëndësishëm! Ju duhet të informoheni sa më shumë që të jetë e mundur para se të zgjidhni cili produkt ose shërbim i sigurimeve më shumë i përshtatet profilit tuaj të rrezikut.

Është shumë e rëndësishme që gjatë zgjedhjes t'i parashtroni pyetjet më poshtë:

- Çka është sigurimi?
- Cilat janë përfitimet nga sigurimi?
- A i kuptoni rreziqet të cilat mbulohen me llojin e sigurimit të cilin e blini?
- A jeni mirë të informuar me kushtet me të cilat lidhet kontrata për sigurim?
- A jeni të informuar për të drejtat dhe detyrimet tuaja të cilat dalin nga lidhja e kontratës për sigurim?
- A janë të mbrojtura në mënyrë adekuate të drejtat dhe interesat tuaja si i siguruar dhe përdorues i sigurimit?
- A jeni të sigurt se mund të paguani primin?
- Përpara dhe gjatë blerjes së kontratës për sigurim konsultoheni me personat e autorizuar.

Zbatimi i Raportit Evropian për raportim të dëmit gjatë aksidentit në komunikacion

Raporti Evropian për Aksidente në Komunikacion është një formë e unifikuar e cila mbushet në rast të aksidentit në komunikacion me dëme të vogla materiale dhe e mbushin pjesëmarrësit në aksidentin e komunikacionit, pa praninë e një oficeri të autorizuar policor.



Raporti Evropian shërben për të përcaktuar situatën faktike të aksidentit dhe nuk përcakton fajin e pjesëmarrësve në aksident.

Dëmi i vogël material nënkupton dëmtimin e automjeteve që nuk janë të dëmtuar në pjesët vitale për drejtim dhe ndalim dhe mund të lëvizin në mënyrë të pavarur. Gjatë përpunimit dhe zgjidhjes së dëmit, për dëmin e shkaktuar në aksident komunikacioni të evidentuar me Raport Evropian, nuk ka bazë ligjore për kufizimin e lartësisë së kompensimit të dëmit.

Byroja Kombëtare e Sigurimit (BKS)

Byroja Kombëtare e Sigurimit është organizatë jofitimprurëse e themeluar në pajtim me Ligjin e Sigurimit të Detyrueshëm në Komunikacion në vitin 1993. Anëtare të BKS-së janë të gjitha 11 kompanitë e sigurimit të cilat kryejnë punë të sigurimit jo-jetë.

Qëllimi i BKS-së është t'i zbatojë kontratat ndërkombëtare të sigurimit të pronarëve dhe përdoruesve të automjeteve nga përgjegjësia për dëme të shkaktuara me përdorimin e automjetit ndaj personave të tjerë dhe t'i përfaqësojë kompanitë e sigurimeve nga Republika e Maqedonisë në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare për sigurime në komunikacion.

Në muajin maj të vitit 1994, BKS-ja u pranua në Këshillin e Byrove me qendër në Londër, si anëtare e plotfuqishme e Këshillit të Byrove dhe fitoi të drejtën të emetojë kartonë të gjelbër maqedonas që njihen ndërkombëtarisht. Me këtë Republika e Maqedonisë u bë pjesë përbërëse e Sistemit të Vetëm Evropian për Karton të Gjelbër.

E rëndësishme!

Pjesëmarrësit në aksidentet e komunikacionit janë të detyruar të thërrasin zyrtarin policor në raste kur:

- një nga automjetet nuk ka targa regjistrimi ose nuk është e siguruar;
- një nga automjetet ka targa të huaja të regjistrimit;
- një nga shoferët e automjeteve është nën ndikimin e alkoolit, drogës ose substancave tjera psikotrope;
- një nga shoferët e automjeteve nuk posedon patentë adekuate të shoferit;
- në aksidentin e komunikacionit ka persona të lënduar;
- shoferët e automjeteve nuk mund të pajtohen me mendimet në lidhje me mënyrën dhe rrethanat nën të cilën ka ndodhur aksidenti në komunikacion;
- një nga shoferët e automjeteve refuzon të japi të dhënat e tij personale, gjegjësisht të dhënat për automjetin; dhe/ose
- një nga shoferët e automjeteve është larguar nga vendi i aksidentit në komunikacion.




Mbani mend

- Qëllimi i sigurimit është të bartet rreziku i cili mund ta shkaktojë dëme materiale dhe jomateriale nga individi tek kompania me anë të lidhjes së kontratës për sigurim (policës).
- Para lidhjes së kontratës, kompania e sigurimeve është e detyruar në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të ndershme, t'i sigurojë konsumatorit informata të sakta, të plota, të kuptueshme dhe të dobishme në lidhje me objektin e kontratës së sigurimit, karakteristikat e produktit ose shërbimit, ta njoftojë me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për sigurimin, pagesën e detyrimeve, si dhe të gjithë informacionet tjera të kërkuara nga konsumatori, përkatësisht i siguruari.
- Mjetet, të cilat në një formë të primit, të siguruarit ua besojnë kompanive të sigurimit, kompanitë i investojnë në plasmane të sigurta dhe të parrezikshme.
- Gjatë shkaktimi të dëmit (rastit të siguruar), kompania e sigurimeve është e detyruar të paguaj shumën e siguruar, përkatësisht të paguaj kompensim ndaj të siguruarit në pajtim me kontratën për sigurim.
- Gjatë raportimit të dëmit në kompaninë e sigurimit dorëzoni të gjithë dokumentet e nevojshme me qëllim të vendimmarrjes dhe pagesës së dëmit.
- Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve kontrollon punën e kompanive të sigurimeve, kujdeset për mirëqenien e tyre financiare dhe i mbron interesat e të siguruarve, përdoruesve të sigurimit dhe palëve të treta të dëmtuara.



Pjesa C

Menaxhimi i borxhit



Paratë e huazuara - kredi dhe borxhe

Si pasojë e qasjes në kredi dhe kartela kreditore të kreditit të ofruara nga ana e institucioneve jofinanciare, mund të josheni të harxhoni më shumë para se sa keni. Kreditë ofrohen për blerjen e shtëpisë, automjetit, për pushime jashtë vendit etj.

E rëndësishme!

Mjetet e përfituara përmes kredive doemos të kthehen, edhe atë me interes!

Para se të huazoni para, mendoni nëse mundeni dhe nëse dini të menaxhoni borxhet personale. Mbani mend se duhet të keni më shumë mjete financiare se sa borxhe. Duhet të përpiqeni të zmadhoni shumën ose vlerën e asaj që posedoni. Nëse huazoni para, ju duhet t'i përdorni për qëllime produktive. Mundoheni të mos përdorni kredi, kartela kreditore ose tejkalime të lejuara për punë të cilat nuk janë domosdoshmërisht të nevojshme.

Hua dhe kredi

Para se të merrni kredi ose të përdorni kartela kreditore e kreditit, parashtroni pyetjet më poshtë:

- A keni nevojë për produktet ose shërbimet të cilat dëshironi t'i blini me para të huazuara?
- Nëse ju nevojiten, atëherë a jeni të aftë të paguani këstet e kredisë ose kartelës kreditore?
- Nëse bëhet fjalë për vlerë më të madhe siç janë blerja e automjetit apo shtëpisë, a mund të lejoni që t'i zvogëloni shpenzimet tjera?

- Nëse ajo është diçka që shumë e dëshironi, por nuk ju nevojitet aq shumë, a mund të kontrolloheni dhe të shtyni blerjen?
- Nëse keni vendosur të merrni kredi për të blerë diçka, a keni bërë paraprakisht një plan financiar që të shihni nëse realisht jeni në gjendje të paguani kredinë?
- A jeni në dijeni sa janë kostot nëse përdorni mjete nga kartela e juaj e kreditit brenda tejkallimit të lejuar? Ju duhet ta dini se ekzistojnë norma interesi dhe lloje të tjera shpenzimesh siç janë shpenzimet për pagesa të vonuara.
- A e dini se cilat janë pasojat nëse nuk jeni në gjendje të paguani borxhet? Në rast të mos pagesës së kësteve të kredisë, do të ndërmerren masa ligjore kundër jush.

Me qëllim që ju të mund të bëni pagesën mujore të kredisë, ndërsa nuk jeni në gjendje të rrisni të ardhurat, duhet të hiqni dorë nga shpenzimet e caktuara. A jeni gati për të bërë këtë hap? Për shembull, a mundeni të hiqni dorë nga shpenzimet për kinema ose një mbrëmje me miq?

Pa marr parasysh se sa me kujdes e keni përgatitur planin tuaj për të paguar borxhin e kredisë ose kartelës kreditore, mund të ndodhi diçka e paplanifikuar, kështu do ju nevojiten para shtesë. Nëse paraqitet ndonjë shpenzim i paplanifikuar, a do të jeni akoma në gjendje të përmbushni detyrimet e juaja?

Për këtë arsye, është e rëndësishme të mos merrni shumë kredi dhe të mos bëni shpenzime të mëdha duke e përdorur kartelën kreditore. Është rregull i përgjithshëm, pagesat totale mujore për të gjithë kreditë dhe kartelat kreditore nuk duhet të tejkalojnë një të tretën e neto pagës tuaj mujore, në të kundërtën do të hyni në borxhe të mëdha.



Institucione të licencuara financiare

Në Republikën e Maqedonisë ka lloje të ndryshme të institucioneve financiare të cilat miratojnë kredi. Institucionet financiare mund të jenë bankare dhe jo-bankare. Institucionet bankare janë bankat dhe kursimoret. Pjesa më e madhe e qytetarëve i përdorin shërbimet e bankave. Bankat dhe kursimoret duhet të posedojnë leje për punë të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.

Bankat janë institucione financiare, aktiviteti kryesor i të cilave është mbledhja e depozitave dhe dhënia e kredive, si dhe kryerja e qarkullimit të pagesave. Bankat janë pjesëmarrësit më të rëndësishëm në sistemin financiar.

Kursimoret janë institucione financiare të cilat ofrojnë shërbime financiare (mbledhin depozita dhe japin kredi), kryesish duke punuar me popullatën. Kursimoret i përkasin grupit të institucioneve depozituese. Në Maqedoni, një bankë nuk mund të themelojë kursimore.

Më shumë informacione për bankat dhe kursimoret mund të merren në internet faqen e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë <http://www.nbrm.mk/>.

Institucionet financiare jo-bankare përfshin shoqatat financiare dhe ofruesit e lizingut financiar (lizing shoqatat).

Kompanitë financiare duhet të kenë leje pune e cila lëshohet nga Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë. Një kompani financiare mund të kryej një ose më shumë nga aktivitetet financiare në vijim: 1) miratimi i kredive; 2) emetim dhe administrim i kartave të kreditit; 3) faktoring dhe 4) emetim i garancive. Përveç aktiviteteve financiare, kompania financiare mund të kryej edhe aktivitetet në vijim: 1) Këshillim lidhur me aktivitetet financiare; dhe 2) dhënien e pronave të tundshme dhe të patundshme për palët e treta, duke përfshirë edhe lizing operativ.

Ofruesit e lizingut financiar, si dhe kompanitë financiare, duhet të kenë leje për punë të lëshuar nga Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë. Lizingu financiar është lizing i cili transferon të gjithë rreziqet dhe përfitimet të cilat dalin nga pronësia e një objekti, qoftë e tundshme ose patundshme, që me kalimin e një periudhe të caktuar

pronësia edhe mund të transferohet. Përparësia e financimit përmes lizing-ut në raport me kreditë është si vijon:

- Procedura e miratimit është konsiderueshëm më e shkurtër dhe më e thjeshtë se format tjera të financimit;
- Mundësi për këtë formë të financimit kanë persona me bonitet më të dobët;
- Blerja me lizing përshtatet sipas dëshirave dhe nevojave të personave;
- Këstet gjatë gjithë periudhës së financimit janë zakonisht të barabarta.

Më shumë informacione për kompanitë financiare mund të merren në internet faqen e Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë <http://www.finance.gov.mk/>.

Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë

Ministria e Financave është pjesë e pushtetit ekzekutiv dhe ka një spektër të gjerë të autorizimeve të përcaktuar me Ligjin e Organizimit dhe Punës të Organeve të Pushtetit Shtetëror.

Qëllimet kryesore të Ministrisë së Financave janë:

- sigurimi i ekonomisë së qëndrueshme dhe rritje më të lartë ekonomike;
- menaxhim i përgjegjshëm i financave publike;
- sigurimi i ekuilibrit fiskal afatgjatë;
- zbatimi i politikës tatimore dhe doganore për përkrahje të qytetarëve dhe subjekteve ekonomike;
- sektor financiar të orientuar kah tregu, stabil dhe konkurrent;
- kualitet të lartë të shërbimeve drejt të gjithë palëve të interesuara.

Me rëndësi! Ministria e Financave i licencën dhe kontrollon kompanitë financiare dhe ofruesit e lizing-ut financiar.

Për më shumë informacione vizitoni internet faqen e Ministrisë së Financave në adresën në vijim: <http://www.finance.gov.mk/>.

Huadhënës tjerë

Përveç institucioneve të licencuara financiare bankare dhe jo-bankë, ekzistojnë edhe huadhënës tjerë, të cilët aktivitetin e huadhënies për kategori të veçanta sociale e kryejnë në pajtim me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji i Shoqatave dhe Fondacioneve dhe ligje tjera të lidhura dhe që kanë mision social dhe principe mbi të cilat bazojnë punën e tyre. Ata shpesh sigurojnë qasje më të lehtë për financim të kategorive të rrezikuara të qytetarëve me kredi për strehim, arsim, mikro-biznes, bujqësi dhe nevoja tjera.

Mikrofinancimi siguron qasje në kredi të vogla (mikrokredi) për familjet me të ardhura të ulëta me qëllim që të mundësojë fillimin e një biznesi, ose mirëmbajtjen e biznes-aktiviteteve aktuale përmes të cilave anëtarët e familjes realizojnë të ardhura. Mikrofinancimi është një model i qëndrueshëm i kreditimit i cili duhet të kënaqi nevojat financiare të qytetarëve më të varfër dhe të marginalizuar dhe bizneseve.

Puna e institucioneve mikrokreditore bazohet mbi konceptin e kreditimit të përgjegjshëm, që do të thotë se ata kujdesen të mos vij deri te mbingarkimi i qytetarëve me borxhe, veprojnë si bashkëpunëtorët e tyre dhe vlerësojnë nevojat dhe mundësitë reale për shlyerje të borxheve.



Lidhja e Organizatave Mikrofinanciare (LOM)

Lidhja e Organizatave Mikrofinanciare përfaqëson interesat e kursimoreve dhe fondacioneve mikrokreditore të cilat janë anëtare të saj dhe ngrit vetëdijen për këtë veprimtari tek publiku më i gjerë.

LOM-i fokusohet në përkrahjen e sipërmarrësve fillestarë, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe të gjithë tjerët të cilat kanë qasje të vështirësuar për shërbime financiare.

Misioni i LOM-it është të kontribuojë në krijimin e një shoqërie në të cilën sektori i qëndrueshëm mikrofinanciar do të sigurojë shërbime adekuate financiare dhe jofinanciare për zvogëlimin e varfërisë përmes promovimit të sipërmarrësisë dhe zhvillimin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe persona tjerë të cilët kanë qasje të vështirësuar për shërbimet financiare.

Më shumë informacione në lidhje me organizatat mikrofinanciare të cilat janë anëtare të LOM-it mund të gjenden në internet faqen: <http://www.mfo.mk/>.

Me rëndësi!

Mos merrni hua prej personave të paautorizuar sepse:

- *Merrni kredi me kushte shumë të pafavorshme;*
- *Duhet të paguani norma shumë të larta të interesit dhe nëse vonoheni me pagesën interesi do të rritet edhe më shumë;*
- *Ju jeni nën presion të merrni hua nga më shumë huadhënës që të shlyeni borxhin e vjetër me një huamarrje të re;*
- *Familja juaj mund të mërzhitet si pasojë e detyrimeve tuaja, të cilat nuk i keni paguar në kohë.*

Llojet e kredive

Ekziston një spektër i gjerë i kredive dhe opsioneve kredituese. Para se të aplikoni për kredi ose kartë të kreditit, duhet të keni informacione të qarta për kushtet dhe detyrimet dhe kontrolloni gjendjen tuaj financiare, gjegjësisht nëse jeni në gjendje të paguani borxhet.

Kredi konsumatore

Është një kredi për konsumin tuaj personal, por jo për blerje të mëdha siç janë blerja e shtëpisë ose automjetit, por për blerje të mallrave dhe shërbimeve, p.sh: Mobilie, pajisje shtëpiake, kompjuter personal, telefon celular etj. Është joshëse të aplikoni për këtë lloj të kredisë, sepse procesi i parashtrimit të aplikimit dhe miratimi i kredisë është zakonisht i shpejtë dhe i lehtë. Përveç kësaj, shumica e bankave nuk kërkojnë garantues ose kolateral nëse kërkuessit e kredisë janë me marrëdhënie të rregullt pune. Megjithatë, kujdes, normat e interesit për kreditë e këtilla mund të jenë më të larta.



Kredi studentore

Studentët kanë mundësi të përdorin kredi studentore prej institucioneve financiare për pagesën e arsimit të lartë. Kredia studentore është e destinuar për studentë të rregullt universitarë dhe pasuniversitarë në universitetet e Republikës së Maqedonisë, si dhe në të gjithë universitetet e akredituara jashtë vendit.

Kredi për veturë

Shumica e njerëzve, pasi të punësohen kanë nevojë për veturë. Ata, nëse nuk janë në gjendje të blejnë veturën me para të gatshme, zakonisht përdorin kredi për veturë.

Si kredi-shfrytëzues, ju paguani këste ndaj huadhënësit në bazë të kushteve të tij. Ju do të fitoni të drejtën e pronësisë së veturës pas mbarimit të të gjithë pagesave dhe shlyerjes së borxhit total.

Si çdo kredi tjetër që keni, njihuni me të gjithë informacionet e rëndësishme para se të vendosni të hyni në borxh. Gjithashtu, bëni një plan financiar që të shihni shumën e kështit mujorë që mund ta përballoni.



Kur aplikoni për kredi për veturë, atë mund të bëni drejtpërsëdrejti me kredithënësin ose përmes tregtarit në një sallon shitjeje të veturave, i cili ka vendosur bashkëpunim me bankën e zgjedhur.

Si kredi-shfrytëzues, është e nevojshme:

- Të lexoni të gjitha kushtet e marrëveshjes;
- Të kontrolloni dhe siguroheni nëse çmimi blerës dhe kushtet për kredinë për veturë janë të shkruara në kontratë në atë mënyrë siç jeni marrë vesh paraprakisht;
- Të njiheni me të drejtat tuaja;
- Të njiheni me detyrimet tuaja si kredi-shfrytëzues, në mënyrë që të mos vini në situatë të shkeljes së kontratës; dhe
- Ruani të gjithë dokumentet, siç janë kontrata dhe pagesat, në një vend të sigurt, sepse ndoshta do ju nevojiten.

Megjithatë, para se të merrni kredi për veturë, kontrolloni normën efektive të interesit e cila është më e lartë nga norma e ofruar në kontratë. Shikoni shembullin e mëposhtëm të kredisë për veturë prej 350.000 denarë dhe normë interesi prej 5% në vit për një periudhë prej 5 viteve. Norma efektive e interesit është 5,12% në bazë vjetore.

*Shuma e kredisë + interesi: **396,296***

*Shuma e kredisë: **350,000***

*Norma e interesit: **5%***

*Interesit total: **46,296***

*Pagesa mujore: **6,605***

*Shuma e kredisë: **350,000***

*Norma e interesit: **5%***

*Afati i shlyerjes: **5 vite (60 muaj)***

*Norma efektive e interesit: **5.12%***

Pagesa e kredisë, në muaj

Muaj	Zvogëlim i borxhit	Kryegjëja	Interesi	Shuma e pagesës mujore - kësti
1	350,000.00	5,146.60	1,458.33	6,604.93
2	344,853.40	5,168.04	1,436.89	6,604.93
3	339,685.36	5,189.58	1,415.36	6,604.93
4	334,495.78	5,211.20	1,393.73	6,604.93
5	329,284.58	5,232.91	1,372.02	6,604.93
6	324,051.67	5,254.72	1,350.22	6,604.93
7	318,796.95	5,276.61	1,328.32	6,604.93
8	313,520.34	5,298.60	1,306.33	6,604.93
9	308,221.75	5,320.67	1,284.26	6,604.93
10	302,901.07	5,342.84	1,262.09	6,604.93
...	...	...	...	...
60	6,577.53	6,577.53	27.41	6,604.93

Kur të merrni kredi për veturë, prej jush kërkohet të paguani interesin e shumës totale (kryegjënë) gjatë periudhës kur është marrë kredia, deri në shlyerjen e kredisë. Këstet e barabarta mujore të kredisë për veturë të cilët i paguani në shumë prej 6.605 denarë, përfshinë pagesën e kryegjësë dhe interesit.

Megjithatë, gjatë pagesës, kryegjëja z vogëlohet, ju vazhdoni të paguani interesin e shumës totale të borxhit prej 350.000 denarë. Norma e interesit të kredisë nuk i merr parasysh pagesat periodike, të cilat përfshin interes dhe kryegjë dhe të cilat gradualisht e zvogëlojnë shumën e borxhit. Rrjedhimisht, gjatë pagesës së kredisë përmes anuitetit mujor, norma efektive e interesit është më e lartë nga norma e interesit me të cilën është marrë kredia për veturë në pajtim me kontratën.



Kredi për banim

Tregu i kredive për banim sot është shumë i zhvilluar. Bankat ofrojnë kredi me kushte të favorshme me qëllim tërheqjen e më shumë klientëve. Me përdorimin e kredive të caktuara, bankat ofrojnë dhurata pa pagesë, udhëtime etj.



Mos nxitoni, përpiqeni të merrni më shumë informata për kushtet dhe normat e interesit, para se të vendosni të merrni kredinë për banim që është e favorshme për ju.



Kredia për banim është një obligim i madh financiar, i cili paguhet gjatë një periudhe të gjatë kohore. Përpara se të merrni vendimin përfundimtar, konsideroni me kujdes për sa vijon:

- A është kredia e destinuar për blerjen e një banese/shtëpie të ndërtuar ose që është në ndërtim e sipër? A blini edhe tokë për ndërtimin e shtëpisë?
- Sa është vlera e shtëpisë ose tokës të cilën doni ta blini? Në varësi të të ardhurave tuaja mujore, çfarë kësti mujor mund të përballoni për pagesë?
- Cilat janë shpenzimet shtesë të cilat duhet t'i paguani dhe a keni para të mjaftueshme për atë? Zakonisht ato janë shpenzime për miratimin e kredisë, për vlerësim, për faturë këmbimi, më pas shpenzime noterie, aplikative, administrative dhe të tjera.
- A është norma e interesit fikse ose e ndryshueshme?
- A ka fleksibilitet gjatë pagesës së kredisë?
- A paguhet një kosto ose komision shtesë nëse e paguani kredinë në mënyrë të plotë para skadimit të afatit të paraparë për pagesë? Nëse doni të ktheni kredinë para afatit, huadhënësit mund të kërkojnë nga ju të paguani kompensime të caktuara për shkak të interesit tërheqës.

A është më mirë të merrni kredi me normë fikse ose variabël (të ndryshueshëm) të interesit?

Në kredinë me një normë fikse të interesit, norma e interesit është fikse dhe për atë arsye ju e dini sasinë e kësteve që duhet t'i paguani.

Në kredinë me normë ndryshueshme të interesit, norma e interesit ndryshon në pajtim me normën bazë të interesit ose normën e interesit të tregut.

Nëse norma bazë e interesit rritet, norma e juaj e interesit do të zmadhohet dhe pagesat e juaja mujore do të jenë më të larta. Në anën tjetër, nëse norma bazë e interesit zvogëlohet, ju përfitoni sepse do të paguani pagesa më të ulëta mujore.

Kredia për banim mund të paguhet në mënyrat në vijim:

- **Pagesë progresive:** Kjo ju mundëson të paguani këste më të ulëta në fillim të pagesës së kredisë. Shuma e kështit gradualisht rritet me kalimin e kohës. Kjo skemë është e dobishme nëse merrni kredi gjatë periudhës kur punësoheni dhe paga juaj është më e ulët dhe me kalimin e kohës do të keni pagë më të lartë dhe do të jeni në gjendje të paguani këste më të larta mujore.
- **Pagesë të pjesshme para kohe të kredisë së pamaturuar:** Mund të shkurtoni afatin e pagesës së kredisë me pagesa të pjesshme para kohe me anë të mjeteve nga kursimet ose bonusi. Nëse kjo bëhet gjatë viteve fillestare të përdorimit të kredisë, ju mund të zvogëloni totalin e kostove në bazë të interesit. Megjithatë, mund të ketë kufizime se sa mund të paguani para afatit të maturimit të kredisë.

Kryegjëja e kredisë zvogëlohet me pagesën e çdo kësti!

Si kredi-shfrytëzues, ju duhet:

- Të lexoni dhe të kuptoni të gjithë afatet dhe kushtet për kredinë;
- Të respektoni kushtet e kredisë;

- Të parashtroi pyetje për të gjithë aspektet e kredisë të cilat ju interesojnë;
- Të paguani këstet në kohë;
- Të kontrolloni rregullisht gjendjen e llogarisë tuaj dhe të keni informacione të sakta për pagesën e kredisë.

Si edhe për çdo kredi tjetër, nëse nuk arrini të paguani këstet tuaja, huadhënësi do të ndërmarrë masa adekuate ligjore kundër jush.

Të qenurit garantues

Mendohuni me kujdes para se të pajtoheni!



Të jesh garantues i kredisë do të thotë nëse kredi-shfërtëyesi nuk është në gjendje ose nuk ka mjete për pagesë të kredisë, ju jeni ligjërisht të detyruar të bëni këtë.

Nëse pajtoheni të jeni garantues, duhet:

- Të lexoni dhe kuptoni çka garantoni dhe cilat janë pasojat për ju;
- Të mos nënshkruani dokument të zbrazët ose pjesërisht të plotësuar;
- Të mos pranoni të jeni garantues i dikujt në të cilin dyshoni; dhe
- Të njiheni me të gjithë detyrimet tuaja nëse ndodhin ndryshime në kushtet e kredisë.

Nuk është lehtë të tërhiqeni nga të qenurit garantues i kredisë. Huadhënësi do të kërkojë të përmbushni kushtet e kontratës për kredi siç është shlyerja e plotë e borxhit kryesor. Nëse huamarrësi vdes, huadhënësi madje mund të kërkojë nga garantuesi të shlyej borxhin e mbetur nëse nuk ka mënyrë ose burim tjetër për pagesë të kredisë.

Kartelat kreditore, debitore dhe të tjera

Kartela me funksion kredie është kartelë e cila i mundëson bartësit blerje dhe/ose tërheqje të parave të gatshme deri në shumën e përcaktuar paraprakisht. Shuma e lejuar e kredisë mund të paguhet plotësisht në fund të periudhës së caktuar kohore, ose mund të paguhet pjesë pas pjese, ku brenda shumës zakonisht përfshihet edhe interesi.



Bartësit shpesh i ngarkohen edhe kompensime tjera, siç është kostoja vjetore për kartelën. Dallimi kryesor midis kësaj kartele dhe kartelës me funksion debiti dhe/ose funksion i shtyrë debiti është në atë se ekziston një marrëveshje ku bartësit i miratohet një shumë kredie (pavarësisht nëse bartësi do t'i përdori ose do të vendosi të paguaj shumën e plotë të borxhit në periudhën e caktuar).

Kartela me funksion debit është kartë e cila i mundëson bartësit huamarrje të drejtpërdrejtë, dhe momentale nga emetuesi i kartelës për kryerjen e një blerjeje ose tërheqjes së parave të gatshme. Mund të jetë e lidhur me llogari e cila lejon mbiterheqje, si një mundësi shtesë e ofruar nga kartela. Dallimi kryesor midis kartelave me funksion debit, në krahasim me kartelat me funksion të shtyrë debit dhe funksion krediti është në atë se në bazë të marrëveshjes, bartësi, gjatë blerjes kryen pagesën drejtpërsëdrejti nga mjetet e llogarisë së tij të transaksionit.



Kartela me funksion të shtyrë të debilit është kartelë e cila i mundëson bartësit blerje me kartelë duke hyrë borxh në llogarinë e emetuesit të kartelës brenda kufirit të lejuar. Shuma e plotë e mjeteve të shpenzuara paguhet në fund të një periudhe të caktuar kohore.

Internet kartelat janë kartela në të cilat nuk deponohen para në një çip ose shirit magnetik, por mund të bëhet mbushje duke transferuar vlerë nga një llogari tjetër dhe të përdoren për pagesa me anë të internetit.

Kartela me funksione tjera është kartelë për dhurata, si dhe kartelë për funksione tjera të cilat nuk mund të klasifikohen në asnjërën nga kategoritë e theksuara të kartelave.

Zakonisht, kufiri i lejuar i kartelës kreditore është 1-2 herë më i madh se paga e juaj mujore. Nëse e përdorni kartelën tuaj deri në këtë kufij, ju harxhoni pagën tuaj më së paku 1-2 muaj paraprakisht.

Një kurth kredie për të paguar një minimum mujor për borxhin e kartelës kreditore

Mund të jetë joshëse të paguani vetëm minimumin mujor të borxhit në kartelën tuaj të kreditit. Për fat që keq, kur paguan vetëm minimumin e çdo muaji - do të bëni shpenzime të interesit çdo muaj dhe do ju marri më shumë kohë për zgjidhjen e problemeve financiare. Çka është rezultati? Borxhe të mëdha për një kohë të shkurtër kohore. Momentalisht, shumica e emetuesve të kartelave ngarkojnë kompensime financiar në bazë mujore.

Ju, paraprakisht u njohët me efektet e normës së përbërë të interesit në situata kur kurseni. Normat e përbëra të interesit aplikohen edhe në këtë situatë, kur interesi paguhet ndaj kryegjësë në të cilën është akumuluar shuma e interesit.



Është e rëndësishme të kuptoni se sa më pak paguani me kartelave e kreditit, aq më shumë para keni. Me normat e larta të interesit në kartelën kreditore, ju do të paguani më shumë para ndaj emetuesit të kartelës në krahasim me shumën origjinale të cilën do e paguani për prodhimin ose shërbimin e blerë.

Paguani sa më shumë që të jetë e mundur dhe sa më herët, që të shlyeni borxhet në kartelën kreditore dhe në këtë mënyrë do të kurseni interesin.

Pagesa e borxhit të kartelës kreditore në tërësi

Edhe pse bëni pagesa të pjesshme të borxhit të kartelës kreditore që është mbi minimumin e nevojshëm mujor, ju përsëri do të paguani interes. Vetëm nëse e paguani shumën e plotë të borxhit të kartelës kreditore atëherë nuk do të paguani interes.

Këshilla për përdorimin e kartelave kreditore

- Paguani shumën e borxhit në tërësi për të shmangur pagesën e interesit.
- Mos përdorni kartelën kreditore nëse nuk jeni në gjendje të kryeni pagesa mujore.
- Kufizoni numrin e kartelave kreditore të cilat i posedoni.
- Mos e përdorni kartelën tuaj të kreditit për të tërhequr para prej ATM-së. Çdo herë që përdorni kartelën kreditore për të tërhequr para, rritni detyrimet tuaja dhe, në disa raste, për tërheqjen e parave nga ATM-ja llogaritet edhe komision.
- Paguani para datës së maturitetit për të shmangur kosto për vonesë të pagesave dhe interes ndëshkues.
- Bëhuni të vetëdijshëm për pasojat nga pagesa e shumës minimale.
- Nëse keni problem financiar, paguani shumën minimale mujore, por përpiqeni të paguani shumën e plotë sa më shpejtë që është e mundur.
- Gjithmonë kontrolloni raportin tuaj mujor të kartelës kreditore që të siguroheni se të gjithë transaksionet tuaja janë regjistruara në mënyrën e duhur. Lajmëroni emetuesin e kartelës nëse ka diçka që nuk është regjistruar në mënyrë të rregullt.



Pagesa dhe mospërbushja e detyrimeve

Huamarrës i mirë është ai i cili pagesat mujore për kredi i paguan në kohë dhe shumën sipas kushteve të marrëveshjes për kredi.

Problem me pagesë të borxhit

Mosrealizimi i pagesës së kredisë dhe mosshlyerja e borxhit në kartelën tuaj të kreditit mund të ketë pasoja serioze. Huadhënësi do të ndërmarr masa ligjore kundër juve. Vetura ose prona juaj do të merren nga ana e përmbaruesit dhe do të nxirren në ankand. Gjithashtu, edhe anëtarët e familjes tuaj do të jenë të prekur, ata ndoshta do të duhet t'ju ndihmojnë në pagesën e borxheve tuaja. Garancitë tuaja për kredi, nëse keni, do të aktivizohen.

Ju do të vuani emocionalisht nga stresi. Vazhdimisht do të merrni thirrje dhe letra nga avokatët, përmbaruesit dhe huadhënësit për t'i shlyer borxhet. Në situata të këtilla, mund të bëheni joproduktiv në punë dhe mund të dëmtoni shëndetin tuaj.



Disa shenja që tregojnë se jeni në vështirësi financiare:

- Nuk keni kontroll mbi paratë tuaja, gjegjësisht shpenzimet janë më të larta se të ardhurat tuaja;
- Keni më shumë borxhe se sa mund të paguani;
- Çdo muaj mund të paguani vetëm minimumin e kartelës tuaj të kreditit;
- Nuk keni asnjë lloj kursimi për të përmbushur nevojat personale dhe familjare për rastet urgjente;
- Merrni thirrje nga përmbaruesit për pagesë të borxheve;
- Merrni padi për borxhin e papaguar;
- Nëse ballafaqoheni me ndonjë prej probleme të theksuara, sa më herët kërkoni ndihmë dhe këshillë për financat nga një këshilltar profesional financiar.


Mbani mend

- Gjithmonë lexoni me kujdes kontratën për kredi përpara se të nënshkruani.
- Kur të aplikoni për kredi, pyesni veten rreth qëllimit për të cilin e merrni kredinë ose borxhin, dhe a mund të paguani kështet duke marrë parasysh gjendjen tuaj financiare.
- Asnjëherë mos merrni mjete nga huadhënës të palicencuar ose fajdexhinj.
- Bëhuni të vetëdijshëm për kushtet e definuara në kontratën e kredisë të cilën e merrni.
- Totali i pagesave tuaja mujore për të gjithë borxhet e kredive dhe kartelave kreditore duhet të jenë më të vogla se një e treta e pagesës tuaj mujore, në të kundërtën do të mbingarkoheni me borxhe.
- Qëllimi është që në kohë të rregulloni borxhin dhe të keni histori kreditore pozitive.



Pjesa Ç

Qëllimet
jetësore



Gjatë jetës është e nevojshme të bëhen zgjedhjet e duhura, qoftë për karrierën, veturën apo shtëpinë. Të bëhen zgjedhje të mençura do të thotë të planifikoni në kohë, të informoheni rreth tregut dhe të mos merrni vendime të përsheptuara. Nëse e lexuat këtë libër që nga fillimi, sigurisht tanimë keni fituar shumë ide për planifikimin e financave dhe menaxhimin e parave. Të njëjtat duhet t'i zbatoni në jetën tuaj.

Kariera juaj

Pas përfundimit të studimeve ju duhet të punësoheni. Kjo do të jetë puna juaj e parë, dhe ndoshta do të keni edhe përvoja tjera pune të cilat do ta formojnë karrierën tuaj.

Pavarësisht nga ajo që do të vendosni ose keni vendosur të bëni në jetë, nëse keni interes të veçantë për një punë të caktuar, sigurohuni që ta doni dhe ta shijoni punën.

Është më mirë të keni talent për atë që do të punoni. Nëse nuk doni numra dhe llogaritje, mos e detyroni veten të punoni si kontabilist. Nëse dëshironi të punoni me njerëz, ndoshta ndërtimi i një kariere në shitje dhe marketing është më e përshtatshme për ju.



Planifikimi i karrierës tuaj

Kariera mbulon një pjesë të madhe të jetës tuaj si person i rritur, prandaj duhet t'i qaseni me seriozitet. Zhvillimi i karrierës do të reflektohet mbi kualitetin e jetës tuaj. Prandaj, planifikoni në mënyrën adekuate. Gjithmonë, kur kaloni në një vend të ri të punës, siguroheni se ai është një hap pozitiv në karrierë, dhe jo vetëm që rrit të ardhurat, por edhe do i zgjerojë edhe mundësitë tuaja për zhvillim të karrierës.

Pavarësisht se është punësimi i parë, shfrytëzoni mundësitë për të mësuar bazat e "mbijetesës" në vendin e punës. Përmirësoni aftësitë tuaja komunikuese! Njerëzit të cilët kanë aftësi të shkruajnë dhe të flasin janë ata të cilët me siguri do të kenë suksese të avancohen në një organizatë. Ushtroni aftësitë për bashkëveprim me të gjithë nivelet e të punësuarve. Ndërmerrni detyra të cilat mund të përmirësojnë diturinë tuaj në një fushë të caktuar. Merrni vullnetarisht pjesë në aktivitete të ndryshme që të tregoni aftësitë tuaja. Lexoni libra dhe literaturë për menaxhim dhe zhvillim personal që të avanconi veten.

Ju mund të ndërtoni karrierën tuaj në organizatën e njëjtë gjatë jetëgjatësisë së punës ose të kaloni nga një organizatë në një tjetër. Pavarësisht nga situata, nëse mendoni për ndryshim të vendit të punës, vlerësoni si puna e re do të rrisë jo vetëm të ardhurat tuaja por edhe diturinë, aftësitë dhe si do të ndikojë në zhvillimin e karrierës. Nëse do ju çojë vendi i ri i punës drejt vendit në të cilin dëshironi të arrini në karrierë? Nëse do ju afrojë drejt qëllimeve tuaja financiare? Pavarësisht arsyes për shkak të së cilës dëshironi vendin e ri të punës, siguroheni se kjo do të jetë e dobishme në plan afatgjatë.

Puna juaj është ashtu si e bëni vetë. Nuk do të jetë as e mërzitshme as e zakonshme nëse e përdorni atë për të zhvilluar veten duke kontribuar në biznesin e organizatës.

Tatim mbi të ardhurat

Ashtu si çdo punonjës, ju duhet të paguani tatim mbi të ardhurat që fitoni në bazë të punës.

Tatimi i juaj mbi të ardhurat llogaritet, hiqet nga paga mujore bruto dhe paguhet drejtpërsëdrejti nga punëdhënësi juaj.



Megjithatë, kjo do të thotë se ju nuk do të paguani tatim mbi të ardhurat në fund të vitit kur do të paraqisni totalin e të ardhurave tuaja. Është përgjegjësia juaj për të raportuar të ardhurat nga të gjithë burimet tuaja dhe të paguani shumën e duhur të tatimit.

Burimet e të ardhurave që fitoni në bazë të punës, duke përfshirë këtu të ardhurat për shërbime të përkohshme për organet e administratës shtetërore, për personat e huaj juridikë dhe të vendit, janë:

- Paga dhe shtesa të pagës,
- kompensime nga kostot e marrëdhënies për punë,
- pensione,
- kompensime gjatë pushimit mjekësor,
- kompensime gjatë mungesës nga puna,
- bonuse,
- të ardhurat e sportistëve profesionistë (bonuse, transfere etj),
- kompensim për sportistë më të mirë,
- të ardhurat e deputetëve, këshilltarëve, anëtarëve të organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse etj.

Mospagesa e tatimit mbi të ardhurat është i dënueshëm!

Drejtoria e të Hyrave Publike të Republikës së Maqedonisë (DHP)

Të dhënat për shumën e pagës mujore dhe të ardhurat në baza të ndryshme dorëzohen nga punëdhënësi juaj deri në Drejtorinë e të Hyrave Publike. Përveç kësaj, punëdhënësi juaj duhet të dorëzojë edhe të dhënat tuaja: emrin dhe adresën, si dhe llojin dhe shumën e të ardhurave.

Përveç formularit të dorëzuar nga punëdhënësi juaj, gjithashtu, ka një formularë të cilin vetë ju duhet ta dorëzoni në DHP, në të cilin duhet të paraqitni të gjithë burimet tjera të të ardhurave.

Është përgjegjësia juaj të llogaritni detyrimin personal tatimor dhe të dorëzoni raportin tuaj tatimor, në mënyrë elektronike ose drejtpërsëdrejti në sportel. Tatimpaguesit inkurajohen të përdorin dorëzimin elektronik përmes sistemit elektronik të DHP-së për dorëzim të raporteve tatimore të cilat janë të shpejta, të lehta dhe të sakta.

Norma tatimore dhe baza tatimore

Të ardhurat të cilat i realizojnë personat juridikë, në vend dhe jashtë vendit, tatimohen me tatim personal të të ardhurave (TPA). Nga 01.01.2008 norma tatimore në bazë të së cilës llogaritet tatimi është 10%. Baza tatimore për llogaritjen e TPA-së është e ndryshme në varësi të llojit të të ardhurave të realizuara ose aktivitetin të cilin e kryejnë personat fizikë. Periudha tatimore për të cilën përcaktohet tatimi mbi të ardhurat është një vit kalendarik (nga 01.01 deri në 31.12.).

Përcaktimi dhe pagesa e tatimit mbi të ardhurat

Përcaktimin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat e kryen DHP-ja në bazë të të dhënave të raporteve tuaja tatimore, librat tuaj afaristë dhe të dhënat zyrtare dhe prova të cilat DHP-ja i gjen gjatë përcaktimit të tatimit.

Pas përfundimit të vitit kalendarik, më së voni deri në 15 mars, personi fizik është i detyruar të dorëzojë raportin tatimor vjetor për përcaktim të TPA-së, në të cilin do të paraqesë të gjithë të ardhurat e realizuara në baza të ndryshme gjatë vitit kalendarik.

Qytetarët, të cilët gjatë vitit kanë realizuar vetëm të hyra nga paga ose pensioni, gjegjësisht vetëm të hyra prej veprimtarisë bujqësore ose të hyra prej veprimtarisë së pavarur, nuk është i detyruar të dorëzojë raport vjetor tatimor.

Me futjen e llogaritjes elektronike (e-TPA), pagesit e të hyrave duke filluar me pagesat që do të kryhen nga 01.01.2018 do të jenë të obliguar t'i dorëzojnë çdo tatimpaguesi të dhëna për totalin e parapagesës së paguar, si dhe të dorëzojnë raporte vjetore dhe mujore.

Me futjen e llogaritjes elektronike (E-TPA), qytetarët nuk janë të detyruar të dorëzojnë raport të parapagesave tatimore për të hyrat të cilat janë subjekt i tatimit dhe janë të kryera në vend dhe jashtë vendit duke filluar nga 01.01.2018.

Përveç të hyrave personale, me tatim të të ardhurave tatimohen edhe këto lloje të të hyrave:

- Të ardhura nga aktiviteti i pavarur (veprimtari afariste - prodhuese, shërbyese, hotelieri, transportuese etj, të ardhura nga shërbimet profesionale dhe intelektuale - shëndetësore, stomatologjike, veterinare, avokat, noter, auditor aktiviteti sportiv etj.; të ardhura nga veprimtaria bujqësore - prodhim, punim, përpunim i prodhimeve bujqësore, kultivim të kafshëve dhe plasmanin e prodhimeve të tyre);
- të ardhurat nga prona dhe të drejtat pronësore (qera);
- të ardhura nga të drejtat autoriale dhe të drejtat e pronësisë industriale;
- të ardhura nga kapitali (dividenda, interes i huave, interes i obligacioneve dhe letrave tjera me vlerë);
- fitim kapital (të ardhura nga shitja e letrave me vlerë, pjesëmarrja në kapital dhe shitja e patundshmërive);
- fitime nga lojërat e fatit;
- të hyra tjera të realizuara në para, naturë ose ndonjë lloj tjetër.

Norma tatimore për të llogaritur tatimin e të ardhurave personale, tatimin e fitimit dhe tatimin e vlerës së shtuar

Tatimi i të ardhurave personale

- nga data 01.01.2018 - normë tatimore prej 10%

Tatimi i fitimit

- nga data 01.01.2018 - normë tatimore prej 10%

Tatimi i vlerës së shtuar

TVSH-ja llogaritet me aplikimin e normave proporcionale tatimore mbi bazën tatimore për qarkullim të kufizuar të mallrave dhe shërbimeve dhe importit, edhe atë:

- sipas normës së përgjithshme tatimore prej 18% dhe
- sipas normës preferenciale tatimore prej 5%



Blerja e veturës

Pasi të punësoheni, një nga vendimet më të rëndësishme është blerja e veturës. Vetura është një mjet i rëndësishëm transportues, jo vetëm për transport deri në vendin e punës por edhe për nevoja tjera të ndryshme. Gjëja kryesore nuk është vetëm blerja e veturës, por ju duhet ta mirëmbani atë, të riparoni nëse prishet dhe të paguani kosto të caktuara siç janë tarifat rrugore, inspektimet teknike dhe sigurimi.

Supozojmë se keni vendosur të blini veturë, a është një veturë e re ose e përdorur? Njerëzit shpesh mendojnë se është më mirë të blihet një veturë e re sepse shpenzimet për mirëmbajtje janë më të ulëta në krahasim me shpenzimet për blerjen e veturës së përdorur. Kjo është e saktë, megjithatë nëse ne dëshirojmë të shesim veturën e re, çmimi do të jetë shumë më i ulët se sa e kemi ble.

Me qëllim që të mos hasni në probleme financiare, varianti më i mirë është që të blini veturë të përdorur që është në gjendje të mirë, ose veturë të re me çmim të volitshëm dhe pagesa për kredi për veturë që mund të përballoni. Megjithatë, gjëja më e rëndësishme është të keni veturë e cila do ju çojë në një destinacion të caktuar në mënyrë komforte dhe të sigurtë. Veturën e ëndrrave mund ta blini atëherë kur të jeni të sigurt se keni mjete të mjaftueshme financiare.

Gjatë blerjes së veturës duhet t'i keni parasysh këto këshilla:

- Kërkoni këshillë prej prindërve tuaj, anëtarëve të familjes ose miqve. Nëse vendosni të blini veturë të përdorur, kërkoni një mekanik, i cili fillimisht do të kontrollojë veturën nëse është në gjendje të rregullt.



- Nëse vendosni të blini veturë të re me kredi për veturë, fillimisht përgatitni buxhetin në bazë të pagës mujore. Merrni parasysh këstin mujor për kredinë për veturë, shpenzimet mujor siç janë benzina, tarifa rrugore dhe parkingu, shpenzime vjetore duke përfshirë sigurimin e veturës, sigurimin kasko, regjistrimin, kontrollin teknik dhe mirëmbajtjen e rregullt, si dhe shpenzime e paplanifikuara për riparim të veturës në rast defekti ose aksidenti.
- Nëse vendosni të aplikoni për një kredi për veturë, përpiqeni të zgjidhni një pako të cilën mund ta përballoni. Përpiqeni të jepni një pjesëmarrje të madhe në shpenzimin e përgjithshëm dhe të aplikoni për kredi më të madhe. Informoheni si është norma e interesit që duhet ta paguani (siç u përmend në pjesën 6).
- Mos përdorni kartën tuaj të kreditit për të paguar pjesëmarrjen. Ky nuk është një vendim i mençur sepse do të sillni veten në situatë të paguani kredi me norma të larta të interesit (në këtë mënyrë do të hyni borxh në kartë me interes, dhe do të duhet të paguani edhe kredinë për veturë në këste me interes).
- Përpiqeni të paguani për karburantin, tarifën rrugore, sigurimin dhe mirëmbajtjen e veturës me para të gatshme ose kartë të debitit, në vend që të përdorni kartën tuaj të kreditit.
- Shmangni përmirësimin e panevojshëm ose ndryshimin e makinës tuaj me pajisje shtesë që do ju ekspozojë në shpenzime shtesë.



Posedimi i veturës nuk është i lirë. Para se të blini atë, kontrolloni nëse keni mundësi të përballoni atë!

Blerja e shtëpisë/banesës

Blerja e shtëpisë/banesës është një prej vendimeve më të rëndësishme financiare të cilin do ta bëni gjatë jetës tuaj, para së gjithash si pasojë e shpenzimeve të larta. Arsyet kryesore për blerjen e shtëpisë/banesës janë:

- Me blerjen e shtëpisë/banesës rritni kapitalin tuaj pavarësisht faktit se e blini përmes kredisë për shtëpi.
- Posedimi i shtëpisë/banesës ju jep ndjenjën e lirisë më të madhe, sigurisë dhe qetësi sepse keni mbulesë të përhershme mbi kokë.

Pronësia kundrejt qirave

Kur posedoni shtëpi/banesë, çdo pagesë mujore të cilën e bëni për kredinë e shtëpisë është sikur të futni para në librezën tuaj të kursimit. Çdoherë që paguhet hipoteka, rritet kapitali juaj. Kjo është njëjtë sikur të keni para në bankë, të cilat mund t'i tërhiqni më vonë në jetë, nëse ju nevojiten. Kur paguani qira, nuk



krijoni asnjë lloj kapitali, mjetet i jepni për shërbim të cilin e fitoni, që është përdorimi i pronës së huaj për një periudhë të caktuar kohore.

Mirëpo, edhe pse blerja e shtëpisë/banesës tingëllon shkëlqyeshëm, kjo nuk është për secilin. Blerja e shtëpisë/banesës zgjat shumë, është një proces i ndërlikuar dhe paraqet një investim të madh:

- Posedimi i shtëpisë kërkon shumë kohë. Duhet të kujdeseni për oborrin, të merreni me riparimet dhe të harxhoni shumë orë për të mirëmbajtur atë. Në fakt ju lidheni për shtëpisë tuaj. Megjithatë, si një qiraxhi në një shtëpi/banesë me qira keni lirinë të lëvizni dhe nuk harxhoni kohë për mirëmbajtjet.
- Për ju si pronar i shtëpisë/banesës, riparimet e vogla dhe përmirësimi i shtëpisë mund t'ju rrisin shpenzimet. Gjatë marrjes së shtëpisë/banesës me qira, normalisht pronari i mbulon shpenzimet për mirëmbajtje.

- Pasi të bëheni pronar i shtëpisë/banesës, mund të ndodhë diçka e papritur që do të ulë vlerën e shtëpisë/banesës - mjedisi mund të jetë i prekshëm nga përmytjet dhe të ndodhi ndonjë fatkeqësi ose disa vite më vonë në afërsi të saj.

– Marrja e shtëpisë/banesës me qira ju jep liri në moment me obligime më të pakta për mirëmbajtje, por krijon edhe mosekzistencë sa i përket shtëpisë dhe jetës tuaj.

– Posedimi i shtëpisë/banesës nuk ju jep liri të madhe sa i përket kohës dhe keni më shumë obligime rreth mirëmbajtjes, por ju mundëson të ndiheni financiarisht të pavarur dhe të sigurt në shtëpinë e juaj.

Lokacioni - kriter i rëndësishëm gjatë zgjedhjes së shtëpisë/ banesës për jetesë

Gjatë blerjes së shtëpisë/banesës, bëni si më poshtë:

- Vizitoni vendin ku mendoni të blini shtëpinë/banesën në periudha të ndryshme të ditës ose javës që të njiheni me fqinjët dhe lagjen.
- Kontrolloni nëse në afërsi të shtëpisë/banesës ka shkollë, shitore, park, fushë sportive, transport publik, pikë karburanti të cilat kontribuojnë për rritjen e vlerës së shtëpisë. Bëni kujdes dhe kontrolloni nëse në afërsi ka kushte dhe objekte të cilat nuk janë të favorshme për jetesë dhe të cilat mund të zvogëlojnë vlerën e shtëpisë/banesës.
- Kontrolloni nëse ka certifikatë pronësie dhe nëse prona është nën hipotekë.
- Bisedoni me ekspertë të cilët mund t'ju japin këshilla për tregun e pasurive të patundshme, lokacione adekuate ose lloje pronash, vlerat e të cilave rriten me kalimin e kohës.

Pagesa gjatë blerjes së shtëpisë/ banesës

Çështja më e rëndësishme gjatë blerjes së shtëpisë/banesës është: Nëse mund të përballoni atë? Si e dhe shumica e njerëzve, do të aplikoni për kredi që të blini shtëpinë/banesën.

Para se të aplikoni për kredi për shtëpi, duhet me kujdes të kontrolloni dhe të analizoni gjendjen tuaj financiare (të ardhura tuaja, kursimet dhe paratë e gatshme).



Merrni parasysh shprehitë e shpenzimit, nevojat aktuale dhe shpenzimet për pagesë të kredisë. Duhet të llogaritni raportin midis të ardhurave dhe shpenzimeve.

Gjithashtu, merrni parasysh rritjet e mundshme të të ardhurave tuaja që do të jenë të nevojshëm për mirëmbajtjen e shtëpisë ose rinovimin në të ardhmen. Gjithë kjo ndikon mbi vendimin tuaj gjatë blerjes së shtëpisë/banesës.

Varësisht nevojave tuaja financiare, ekzistojnë lloje të ndryshme të kredive për shtëpi. Mundohuni të paguani më shumë se 10% të çmimit të blerjes së shtëpisë si pjesëmarrje, që të shmangni aplikimin për një kredi më të lartë për shtëpi. Keni parasysh se duhet të keni para të mjaftueshme për lloje të tjera të shpenzimeve siç janë: taksat gjyqësore, sigurimi, tatimet, regjistrimi në kadastër etj.

Sigurohuni se mund të blini dhe të paguani shtëpinë/banesën, në të kundërtën ëndrra juaj për shtëpi/banesë do të kthehet në një ankth.

Blerja e pronës

Investimi në pronë mund të jetë një mjet i fuqishëm për krijimin e kapitalit. Si një pjesë e strategjisë tuaj investuese, ka disa çështje të cilat duhet të merren parasysh para investimit në pasuri të patundshme.

- Sa do të kontribuojnë investimet në prona për të rritur pasurinë (kapitalin) tuaj?
- Nisur nga fakti se prona nuk është likuide, gjegjësit nuk mund të shitet shpejt, a do të paraqesë problem për ju kur të keni nevojë për para të gatshme?
- A do mund të ballafaqoheni me pronësi afatgjate dhe mirëmbajtje të pronës, nëse rrjedha e juaj e parave të gatshme nuk është e përhershme?
- Sa të ardhura prisni nga investimi në pronë kur të pensionoheni?
- A prisni që prona t'ju sigurojë të ardhura të menjëhershme ose rritje afatgjate të vlerës së kapitalit?



A jeni të përgatitur të ballafaqoheni me përgjegjësitë e të qenurit pronarë i pronës? Kjo nuk është një detyrë e lehtë. Të ardhura shtesë do të keni nëse e jepni pronën tuaj me qira duke ngarkuar qira për të. Keni kujdes, mund të ketë raste kur qiraja nuk do të paguhet ose pagesa do të vonohet. Ndoshta nuk do ju pëlqejë sjellja e qiramarrësve tuaj dhe do të duhet t'i shpërngulni ato. Ekzistojnë më shumë detyrime për mirëmbajtje të pronës para dhe pas si të jepet me qira; riparime të cilat duhet të bëhen, përditësim i dokumentacionit, paraqitje e të ardhurave, pagesë e tatimeve etj. Kuptohet, ju mund të angazhoni profesionistë të kujdesen për disa prej këtyre punëve në vendin e juaj, por edhe për këtë duhet të paguani kompensim shtesë.

Pa marr parasysh nëse blini shtëpi/banesë për jetesë ose shtëpi/banesë si investim, lokacioni është gjëja primar. Lokacioni i mirë ju ndihmon të tërhiqni qiramarrës, të fitoni të ardhura më të mëdha nga qiraja dhe të rrisni vlerën e shtëpisë/banesës tuaj.

Filloni duke investuar në një pronë të vogël, që të mund të menaxhoni financat me sukses. Më vonë, me përvojën e fituar dhe mjetet e fituara financiare, mund të blini pronë më të madhe.

Kur bëhet fjalë për zemrën

Gjatë jetës, mund të takoni personin me të cilin do të dëshironi të kurorëzoheni. Kurorëzoheni vetëm nëse jeni gati të merreni me detyrimet e martesës.

Dasma

Bëhuni real në lidhje me shpenzimet për dasmë. Do të befasoheni se sa shpenzime ka për përgatitjen dhe organizimin e dasmës, ndër tjerash për restorant, muzikë, fotografi, veshmbathje, dhurata etj.



Si dhe për aspektet tjera të jetës tuaj, planifikoni buxhetin tuaj. Numëroni të gjithë sendet e nevojshme që nevojiten për dasmë. Bisedoni hapur me bashkëshortin tuaj se sa para mund të shpenzoni. Kërkoni këshillë prej atyre që tanimë kanë kaluar nëpër këtë proces, me qëllim që të sillni vendime të drejta se si do t'i shpenzoni mjetet për këtë ngjarje.

Mos mundoheni të jetoni sipas pritjeve të njerëzve tjerë dhe të shkoni të merrni hua prej familjes ose miqve, po pse jo edhe prej bankës, që të paguani dasmën tuaj. Në fakt ju duhet të parashikoni koston e dasmës tuaj në kuadër të planit tuaj financiar. Ekzistojnë shumë raste të bashkëshortëve të cilët ballafaqohen me probleme si pasojë e borxhit të lartë i cili është krijuar gjatë dasmës së tyre. Shpesh, problemet financiare çojnë në probleme tjera në të ardhmen.

Martesa dhe familja

Është shumë e rëndësishme që ju dhe bashkëshorti juaj të bisedoni hapur, "sy me sy", për çështjet lidhur me paratë (këto këshilla supozojnë se të dy bashkëshortët janë të punësuar);

- Plani i juaj financiar duhet të jetë një plan i përbashkët financiar, i krijuar bashkërisht me bashkëshortin tuaj.
- Bashkërisht të vendosni si të trajtoni shpenzimet për fatura, pagesa për familjen dhe fëmijët, menaxhimin e amvisërisë, si dhe kursimet dhe investimet.



- Për pagesë të shpenzimeve të përbashkëta, ndani para në bazë mujore nga llogaria e përbashkët. Mos harroni të kontrolloni listën e shpenzimeve të përbashkëta sa më shpesh, së paku një herë në muaj, që të shihni nëse shpenzimet rriten, për shembull, si pasojë e inflacionit ose stilit tuaj jetësorë si bashkësi bashkëshortore.
- Nëse bashkërisht vendosni të përdorni kartelë kreditore që të paguani ndonjë shpenzim të përbashkët, është e rëndësishme që personi i cili e përdor kartelën kreditore të ketë qasje në paratë e llogarisë së përbashkët, që të mos ketë komplikime më vonë gjatë pagesës së borxhit.
- Njëjtë si në planin tuaj individual, duhet të ndani mjete dhe në fondin e përbashkët për raste emergjente të cilin do të përdorni për shpenzime të papritura që mund t'ju ndodhin juve, bashkëshortit tuaj ose familjes. Vendosni shumën të cilën do ta ndani si kursim të përbashkët, në të njëjtën kohë edhe të gjithë mjetet e disponueshme mund t'i transferoni në fondin e juaj të përbashkët për pension.
- Bisedoni hapur për investime, secili me dëshirat dhe preferencat e tyre. Është e mençur të keni portofol të përbashkët për investime që të plotësoni qëllimet e ardhshme financiare, siç janë pensionimi dhe jeta e rehatshme. Investimet normalisht përdoren për të paguar shpenzimet për jetën dhe arsimimin e fëmijëve tuaj.
- Mendoni mirë, ndoshta do nevojitet të zgjeroni portofolin tuaj në sektorin e sigurimi: sigurimi i jetës, sigurimi shëndetësor, sigurim nga fatkeqësitë, sigurimi i pronës etj.

Borxhe financiare

Sinqerisht bisedoni me bashkëshortin tuaj të ardhshëm për borxhet që ju sillni në martesë (nëse keni). Që të dy do të duhet të shlyeni borxhet personale në periudhën pas martesës, nëse nuk jeni në gjendje ti shlyeni para se të kurorëzoheni.

Nëse është e nevojshme të aplikoni për kredi ose kartelë kreditore pasi të martoheni, do të duhet të bisedoni dhe bashkërisht të vendosni se si do të shlyeni detyrimin e ri të borxhit. Të dy bashkëshortët duhet të pajtohen me kushtet për pagesë dhe periudhën për shlyerje të borxhit.

Ju dhe bashkëshorti juaj nuk duhet të fshihni borxhet tuaja nga njëri-tjetri. Disa martesa janë të destinuara të dështojnë pikërisht si pasojë e borxheve financiare të shkaktuara nga bashkëshortët.



Pasqyra financiare

Praktikë e mirë që bashkëshortët të përgatisin buxhet mujor, plan për shpenzime dhe plan për monitorim të shpenzimeve. Është gjithashtu e nevojshme të rishikohet gjendja dhe rrjedhat e mjeteve dhe detyrimeve në bazë mujore.

Kthejeni rishikimin në një aktivitet të përbashkët një herë në muaj. Bisedoni rreth mënyrave që të përmirësoni financat në familje dhe të zbuloni ide kreative dhe mënyra për të fituar më shumë para.

Kursimi për pension

Ju kurrë nuk jeni as shumë të ri, as shumë të vjetër që të planifikoni kursimin tuaj për pension. Më herët është gjithmonë më mirë, por edhe më vonë është më mirë se kurrë.



Megjithatë, është e pëlqyeshme të krijohet një shprehje për kursim për presion që në moshë më të re. Në fakt, shprehja për kursim duhet të jetë pjesë e stilit tuaj për jetesë. Është mirë të mendoni për më shumë mjete në llogarinë e kursimeve për pension, që do t'ju ofrojë një mënyrë të rehatshme jetese edhe në ditët e pensionimit.

Kur jeni të ri, zakonisht nuk mendoni për ditët e pensionimit. Pensionimi është një temë e largët për njerëzit e të gjithë moshave. Edhe njerëzit që janë në të 50-tat e tyre nuk duan të mendojnë për mundësinë e pensionimit. Ato kanë obligime të ndryshme, rreth shtëpisë, arsimit të fëmijëve, kujdesin shëndetësor për prindërit dhe shumë punë tjera me prioritet për të cilat ata duhet të kujdesen.

Megjithatë, ekziston frika nga e panjohura. Askush nuk e di se çka do të ndodhë me ju kur të plakeni, ky mendim disa herë mund t'ju ndalojë të ndërmerreni aktivitete për mirëqenien tuaj financiare në të ardhmen. Të gjithë më shumë dëshirojnë të jetojnë në të tashmen, se sa të planifikojnë për të ardhmen e largët. Ndoshta keni frikë t'ja pranoni vetes se nuk jeni në rrugën e duhur nëse filloni të planifikoni. Ndoshta e dini se keni shpenzuar shumë para, se aftësia juaj për një fitim më të madh nuk përmirësohet dhe se nuk jeni në mundësi të rritni kursimet tuaja.

Megjithatë, nëse filloni të kurseni sa më herët që është e mundur, do të jeni në një gjendje shumë më të mirë se ajo që mendoni. Nëse rregullisht kurseni para dhe fitoni shprehinë e kursimit, ju vetë do të ndieni se e forconi gjendjen tuaj financiare.

Nëse filloni të kurseni më herët në jetën tuaj, ju do të keni në dispozicion mjetet e nevojshme edhe në periudhën para pensionimit.

Bazat e planifikimit për pension

Ashtu si për çdo proces planifikimi, ju duhet të keni informacionet që ju nevojiten:

- Sa kursime dhe mjete financiare keni për momentin?
- Sa janë të ardhurat tuaja mujore?
- Sa është përqindja që ndahet nga të ardhurat tuaja për detyrime për fondin e pensionit?
- Edhe sa vite ju kanë mbetur deri në pensionim?

Pas analizës së mjeteve dhe detyrimeve tuaja aktuale, vlerësoni nevojat tuaja për shpenzim, dhe pastaj vendosni në lidhje me periudhën kohore në të cilën mund vullnetarisht të kurseni për pension.

Llogaritni edhe shumën mujore që do ju nevojitet për standardin e dëshiruar të jetës kur të dilni në pension. Plani i juaj për pension duhet të përfshi zvogëlimin e borxhit, buxhetimin, diversifikimin e investimeve dhe më e rëndësishmja nga të gjitha ruajtja e shëndetit përmes ushqimit të shëndetshëm dhe lëvizjes së rregullt.

Gjendja e mirë shëndetësore është me rëndësi të madhe gjatë plakjes. Kostot shëndetësore mund të jenë shpenzimi kryesor dhe dalja e vetme nga kursimi për pension. Edhe nëse keni sigurim shëndetësor dhe sigurim jetësor i cili mbulon sëmundjet kritike dhe invaliditetin, ai mund të mos përfshijë të gjithë procedurat dhe recetat të cilat duhet t'i përdorni nëse ju përkeqësohet shëndeti. Disa here, sëmundje të caktuar janë pjesërisht të mbuluara ose aspak të mbuluara nga sigurimi. Prandaj, duhet të bëhet një plan adekuat për kursim për pensionim me qëllim ruajtjen dhe jetesën e shëndoshë.

Plan kohor për pension

- Informohuni rreth sigurimit tuaj të pensionit sapo të punësoheni.
- Mendoni rreth llogarisë tuaj individuale për pension dhe në çfarë mënyre mund të rritet kursimi për pension, nëse u rriten të ardhurat.



- Me kalimin e viteve, rritni kursimet për pension me një përqindje të caktuar nga të ardhurat tuaja në dispozicion. Për shembull, nëse filloni të punoni në moshën 25 vjeçare me kursim prej 10% (të të ardhurave tuaja) dhe vendosni të rritni kursimin tuaj për 1% çdo vit, në moshën 26 vjeçare, do të kurseni 11% nga të ardhurat tuaja dhe pas 35 viteve, do të kurseni nga 20 përqind të të ardhurave tuaja.
- Kurseni një pjesë të çdo rritjeje të të ardhurave tuaja ose të bonuseve vjetore dhe për kursimet tuaja për pension. Mundoheni që në buxhetin tuaj mujor të siguronit një shumë për mjetet e kursyera të destinuara për pensionim.
- Nëse keni kursim për pension, shqyrtoni portofolin për investime, që të siguroheni se paratë tuaja rriten dhe se mund të realizoni planin tuaj për pension.

Siguroni një jetë të qetë dhe të rehatshme

Edhe pse në botën moderne paratë janë të domosdoshme, ata paraqesin gjithçka në jetë. Ata nuk janë shkaku i vetëm i jetës. Është shumë e rëndësishme të keni një jetë të qetë dhe të rehatshme. Shëndeti dhe familja janë elementet më të rëndësishme të cilat kontribuojnë për lumturinë e të gjithë anëtarëve të familjes.

Përpiqeni t'i bëni të lumtur edhe të tjerët, dhuroni dhe jepni mbështetje dhe ndihmë për njerëzit e rrezikuar që të lehtësoni vështirësitë në jetën e tyre.

Punoni që të bëni ekuilibër në jetën tuaj ku paraja nuk është arsyeja e vetme për jetë.

Financimi Kapital i Sigurimit Pensional në Republikën e Maqedonisë

Sistemi i pensionit maqedonas përbëhet prej tre shtyllave dhe është pjesë e sistemit për sigurim social. Shtylla e parë përfaqëson Fondin Shtetëror të Sigurimit Personal dhe Invalidor në Maqedoni, i cili funksionon në bazë të parimit të financimit aktual (ang. pay-as-you-go). Shtylla e dytë dhe e tretë janë financim kapital, në parim të kontributeve të përcaktuara, ku shtylla e dytë është e obligueshme

ndërsa shtylla e tretë është vullnetare. Zhvillimi i shtyllës së dytë dhe të tretë mundëson investimin e mjeteve të fondeve pensionale për realizimin e kthimit më të lartë në të mirë të anëtarëve të tyre dhe anëtarëve të pensionuar. Shtylla e dytë dhe e tretë rregullohen dhe kontrollohen nga Agjencia e Mbikëqyrjes të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional.

Fondet pensionale nga shtylla e dytë e obligueshme dhe shtylla e tretë vullnetare përfshinë mjetet e paguara nga kontributet e anëtarëve të tyre dhe kthimin nga mjetet e investuara.

Mjetet nga fondet pensionale të shtyllës së dytë të obligueshme dhe shtyllës së tretë vullnetare janë plotësisht të ndara nga mjetet e shoqatave pensionale të cilat menaxhojnë me fondet dhe u janë besuar për ruajte në bankat kujdestar të pronës, që kanë rëndësi të madhe me qëllim që të arrihet një nivel i lartë i sigurisë së mjeteve.

Shtylla e tretë vullnetare e pensionit u formua me qëllim që qytetarëve tu mundësohet të përmbushin pensionin nga shtylla e parë dhe e dytë pensionale dhe të sigurohen të ardhura shtesë për pleqëri. Anëtarët individual të shtyllës së tretë vullnetare kanë mundësi të realizojnë kthim të tatimit personal të mjeteve të paguara në fondin pensional vullnetar.

Agjencia e Mbikëqyrjes të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional

Agjencia e Mbikëqyrjes të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional është themeluar në vitin 2002 nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. MAPAS është themeluar me qëllim të mbikëqyrjes së punës së fondeve pensionale me qëllimin përfundimtar për t'i mbrojtur interesat e anëtarëve të fondeve pensionale (të siguruarit).

MAPAS është përgjegjëse për emetimin, tërheqjen dhe marrjen e lejeve për themelimin të shoqatave pensionale, lejeve për kryerjen e veprimtarisë - menaxhim me fonde pensionale dhe emetim, tërheqjen dhe anulimin e miratimeve për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare. MAPAS kryen mbikëqyrjen e punës së shoqatave pensionale, fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare, si dhe kujdestarëve të pronës.

MAPAS gjithashtu promovon, organizon dhe nxit zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe zhvillon ndërgjegjen e publikut për qëllimet dhe parimet e shoqatave pensionale, fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare, për qëllimet, parimet dhe përfitimet nga pjesëmarrja në një skemë profesionale pensionale, për të drejtat e anëtarëve të fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe për çështje tjera në lidhje me financimi kapital të sigurimit pensional.

Më shumë informacione në lidhje me punën e MAPAS dhe financimin kapital të sigurimi pensional mund të gjeni në internet faqen e MAPAS: www.mapas.mk

Mbani mend

- Planifikimi i karrierës është i rëndësishëm që të mund të rritni aftësinë tuaj për të fituar.
- Gjatë blerjes së veturës së re përmes kreditit për veturë, fillimisht është e rëndësishme të kontrolloni nëse jeni të aftë të përballoni atë. Ekzistojnë edhe shpenzime tjera për mirëmbajtjen e veturës, përveç harxhimeve për kështet për pagesë të kredisë për veturë.
- Blerja e shtëpisë/banesës është një vendim i madh financiar. Krahasoni përfitimet nga marrja e shtëpisë/banesës me qira përkundër blerjes së shtëpisë/banesës.
- Ju dhe bashkëshorti juaj duhet të jeni të përgatitur të bisedoni për çështjet financiare dhe të përgatitni një plan të përbashkët financiar.
- Kurrë nuk është shumë herët, as shumë vonë për të planifikuar për kursime për ditët e pensionit.
- Punoni që të bëni ekuilibër në jetën tuaj ku paratë nuk janë arsyeja e vetme për të cilën jetoni.
- Mendoni për kursimin tuaj individual për pension dhe përpiqeni të bëheni anëtarë të shtyllës pensionale (të tretë) vullnetare. Kjo do ju mundësojë të plotësoni pensionin dhe të siguronit të ardhura shtesë në ditët e pensionit.



Vështirësitë financiare

Nëse ndiqni këshillat e dhëna në këtë libër, nuk do të hyni në vështirësi financiare. Do të menaxhoni paratë tuaja në mënyrë të mençur dhe nuk do të silleni në situatë të keni probleme dhe strese të mëdha.

Në plan afatgjatë, nuk guxoni të dorëzoheni përpara ideve tuaja të parafytyruara dhe vështirë të realizueshme, të cilat do ju bëjnë shpenzime të mëdha, para se të mendoni se si kjo do të reflektohet në ardhmërinë tuaj. Nëse nuk i planifikoni financat, ka shumë të ngjarë të shpenzoni më shumë se sa fitoni dhe seriozisht të hyni në borxh, gjë që çon drejt vështirësive financiare.

Situata e juaj e vështirë financiare do të ndikojë edhe mbi reputacionin tuaj. Duke kërkuar para për të shlyer borxhet, do të jeni emocionalisht të pakënaqur, është e mundur të përkeqësoni marrëdhëniet me miqtë dhe familjen. E gjithë kjo ndikon mbi shëndetin tuaj momental mental dhe fizik dhe stabilitetin e juaj emocional. Problemet tuaja nuk do të përfundojnë kurrë, vetëm për shkak se nuk i keni planifikuar financat dhe nuk i keni kontrolluar shpenzimet.



Aftësia kredituese

Siç është shpjeguar në pjesën 6, informacionet kreditore të debitorëve përditësohen dhe mirëmbahen në sistemet informative të institucioneve financiare dhe mund në çdo kohë të kontrollojnë statusin e juaj kreditor.

Nëse keni borxhe serioze dhe kërkon kredin nga banka, aftësia e juaj kreditore do të jetë me bonitet të keq. Institucionet financiare kanë kriteret e ndryshme për të kontrolluar aftësinë kreditore të kërkuesve të mundshëm të kredive. Si për shembull: Sjellja e kredikërkuesit ndaj detyrimeve për shlyerje të kredisë sipas kredive të shfrytëzuara më herët, kapacitetin për shlyerje të kredisë dhe kriteret tjera në pajtim me politikën e biznesit të institucioneve financiare.

Nëse keni aftësi të dobët për kredi, është vështirë të fitoni kredi nga cilido institucion financiar.

Çka mund të ndodhë?

Kur nuk e paguani kredinë, huadhënësi do të ndërmarr masa juridike kundër juve. Fillimisht do të merrni një aktgjykim. Nëse është një kredi për veturë, huadhënësi do të marri pronësinë dhe do të shesë veturën. Nëse është kredi për banim i kolateralizuar me pronë, huadhënësi do të marr pronën dhe do të shesë atë në një ankand publik.

Për kreditë e pakolateralizuara, huadhënësi ka opsione të shumta për mënyrën e zbatimit të aktgjykimit për kthimin e pasurisë së tij.

Kontroll i aftësisë tuaj për kredi

Bankat kanë tendencë të miratojnë kredin për persona të cilët i vlerësojnë si të aftë për kredi. Për këtë qëllim, burimet e informacioneve për historinë tuaj kreditore dhe borxhin aktual janë shumë të rëndësishme. Baza e të dhënave dhe informacioneve për ekspozimin e kredisë të bankave dhe kursimoreve ndaj klientëve të tyre gjendet në Regjistrin kreditor në Bankën Popullore dhe Byronë Maqedonase të Kreditimit.

Regjistri kreditor i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë

Regjistri kreditor paraqet bazë të të dhënave dhe informacioneve për ekspozim kreditor të bankave dhe kursimoreve në Republikën e Maqedonisë ndaj klientëve të tyre, qëllimi kryesor i të cilit është të kontribuojë për përmirësimin e kualitetit të kredive për ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar. Regjistri kreditor është një koleksion i të dhënave personale, kontrollor i të cilit është Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.

Qëllimi i Regjistrimit kreditor është të mundësojë: centralizimin e të dhënave dhe informacioneve për ekspozim të kredisë ndaj klientëve, të dorëzuara nga ana e bankave dhe kursimoreve; përdorimi i të dhënave dhe informacioneve për ekspozim të kredisë ndaj klientëve, për nevojat e menaxhimit të rrezikut të kredisë; përdorimi i të dhënave dhe informacioneve për ekspozim të kredisë ndaj klientëve, të bankave dhe kursimoreve individuale dhe sistemit bankar në tërësi, nga ana e Bankës Popullore, për nevojat e kryerjes së funksionit të mbikëqyrjes.

Më shumë informacione në internet faqen: <https://www.nbrm.mk/kreditin-registar-al.nsp>

Byroja Maqedonase e Kreditimit (BMK)

Byroja Maqedonase e Kreditimit SHA Shkup është byro kreditore private në Republikën e Maqedonisë. Është themeluar kah fundi i vitit 2008 si një shoqatë aksionare nga ana e Shtëpisë së Kliringut Sisteme të kliringut ndërbankar AD Shkup.

Funksioni i saj kryesor është mbledhja dhe përpunimi i plotë ose pjesshëm të dhënave për detyrimet e subjekteve dhe/ose të dhëna tjera të përcaktuara me Ligjin e Byrosë Kreditore, me qëllim që të sigurohen raporte për borxhin dhe rregullshmërinë e shlyerjes së detyrimeve nga ana e subjektit të të dhënave.

Në Byronë Maqedonase të kreditimit dorëzohen të dhëna për persona të cilët lidhen me detyrimet në bazë të kredive, garancioneve, akreditiveve, borxheve, kartave të pagesës, lizingut financiar, sigurimit, detyrime në bazë të tatimeve, detyrimeve në bazë të shërbimeve të telekomunikimit, detyrime për shërbime nga fusha e energjetikës, ngarkesa komunale, tatime, kontribute, si dhe detyrime në bazë të përdorimit të shërbimeve tjera. Më shumë informacione në internet faqen: <http://mkb.com.mk/>

Identifikoni sinjalet

Fatkeqësisht, ekzistojnë njerëz që nuk kuptojnë se realisht gjenden në problem financiar. Ata vazhdojnë të jetojnë në mënyrën e njëjtë, duke refuzuar realitetin dhe në atë mënyrë e përkeqësojnë situatën nga dita në ditë.

Ka disa shenja në kategori të caktuara financiare të cilat sinjalizojnë se gjendeni në probleme financiare dhe duhet të jeni të vetëdijshëm për këtë. Ata janë:

Shenjat negative lidhur me borxhet në bazë të kartelave kreditore

- Pagesë vetëm për shumën minimale për pagesë çdo muaj;
- Rritja e borxheve çdo muaj;
- Tejkalmi i limitit tuaj të kredisë;
- Tërheqja e shpeshtë e parave të gatshme; dhe
- Bllokimi i kartelës kreditore.



Shenja negative lidhur me borxhet në bazë të kredive

- Njoftime nga bankat për borxhe të papaguara;
- Kërkesë e refuzuar për kredi për shkak të rejtingut negativ;

- Huamarrja e parave nga familja ose nga miqtë për pagesë të borxheve; dhe
- Refuzim i rregullt i thirrjeve/lajmërimeve për borxhe nga huadhënësit tuaj.

Mungesa e kursimeve

- Nëse janë shpenzuar të gjithë kursimet,
- Nëse nuk keni asnjë lloj kursimi që të mbuloni shpenzime të papritura.

Kur shpenzimet e rregullta bëhen një kafshatë e madhe për tu përlypur

- Të vareni nga puna shtesë, punë jashtë orarit, bonuse dhe të tjera për të paguar shpenzimet tuaja për jetesë;
- Të jetoni nga rroga në rrogë;
- Shpesh grindeni me bashkëshortin lidhur me paratë; dhe
- Nuk e dini se sa para keni borxh para se të vijnë faturat dhe nuk i paguani ato në kohë.



Nëse ju ndodh një nga rastet e përmendura, menjëherë filloni zgjedhjen e tij. Mos pritni që problemi të rritet. Sa më herët të ndërmerren aktivitete, aq më shpejt do të dilni nga situata e vështirë financiare.

Nëse nuk veproni menjëherë kur të identifikoni shenjat se keni problem financiar, do të përkeqësohet edhe më shumë...

Mbani mend

- Ekzistojnë shenja të cilat sinjalizojnë se keni probleme financiare. Nëse njihni ndonjë nga këto shenja, duhet të veproni urgjentisht që të tejkaloni problemet.
- Nëse keni borxhe të cilat nuk mund t'i menaxhoni, kjo do të reflektohet në të gjithë aspektet e jetës tuaj.
- Pagesë dhe shlyerje e rregullt dhe hyrjet e rregullta financiare janë kriter kryesor për aftësinë e mirë kreditore të huakërkuesit.
- Huadhënësit do të ndërmarrin masa ligjore kundër juve nëse nuk i përmbushni detyrimet e kredisë tuaj plotësisht dhe në kohë.



Literatura e përdorur

Internet faqe

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimit: <http://aso.mk/>

Agjencia për Mbikëqyrjen e Financimit Kapital të Sigurimit Pensional:
<http://mapas.mk/>

Komisioni i Letrave me Vlerë: <http://www.sec.gov.mk>

Ministria e Financave: <http://www.finance.gov.mk/>

Byroja Maqedonase e Kreditimit <http://mkb.com.mk/>

Bursa Maqedonase <http://www.mse.mk/mk/>

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë <http://www.nbrm.mk/>

Lidhja e Organizatave Mikrofinanciare <http://mfo.mk/index.php/en>

Drejtoria e të Hyrave Publike e Republikës së Maqedonisë

<http://www.ujp.gov.mk/>

Fondi për Sigurimin e Depozitave të Republikës së Maqedonisë

<http://www.fodsk.org.mk>

Depozitari Qendror i Letrave me Vlerë <http://www.cdhv.mk/>

Literatura

Money \$ense, Getting Smart with your Money, Agensi Kaunseling dan
Pengurusan Kredit (AKPK), Third Edition, 2014, Kuala Lumpur, Malaysia



Është e
rëndësishme sa
fitoni, mirëpo është
edhe më e
rëndësishme si i
shpenzoni fitimet!"

